


BIBLIOTEKA
SHTETIT

949.65
M 59

Myftar Memia


LIDHJA
SHQIPTARE
E PRIZRENIT
NE KENGET
E POPULLIT



94P.65
11/59

MYFTAR HYSEN MEMIA

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT
NË
KËNGËT E POPULLIT



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

«... rilindasit, duke luftuar për lirinë e Shqipërisë, luftonin në të njëjtën kohë për unitetin territorial të saj, sepse ata e panë mirë ç'rrezik të madh përfaqësonin në këtë drejtim lakmitë territoriale dhe aktet shoviniste barbare të fqinjëve grekë, serbë, malazezë dhe italianë, si dhe përpjekjet e fuqive të mëdha evropiane për copëtimin e atdheut të tyre që vazhduan pa ndërprerje e që vazhdojnë akoma edhe në ditët tona. Pikërisht për këtë arsy, në një moment shumë kritik, për të siguruar lirinë dhe unitetin territorial të vendit dhe si përgjigje kundër komplotit të Kongresit të Berlinit, u organizua më 1878 Lidhja historike e Prizrenit, me Abdyl Frashërin në krye».¹⁾

ENVER HOXHA

1) Enver Hoxha, vepra, vëll. 24, Tiranë 1977, f. 11.

H Y R J E

Populli shqiptar gjatë gjithë historisë së tij kurrë nuk e ka lëshuar pushkën nga dora dhe me guxim e trimëri të pashoqe e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë. Ai ka luftuar njëkohësisht në dy fronte: në frontin e jashtëm, kundër pushtuesve të huaj të njëpasnjëshëm dhe në frontin e brendshëm kundër klasave shtypëse e shfrytëzuese, që ishin e vetmja mbështetje shoqërore e politike e të huajve.

Me luftërat e tij të drejta çlirimtare, pa asnje përkrahje morale apo materiale nga jashtë, populli ynë shkroi me gjak çdo fajqe të historisë së tij kombëtare. Me mprehtësi e qartësi politike dhe me mjeshtëri të rrallë artistike ai e ka përjetësuar në këngë historinë e vet. Këtë e ka sintetizuar me art në epikën historike, e cila u ka qëndruar jo vetëm vitezave e dekadave, por edhe shekujve. Këngët populllore, duke kaluar nga një brez te tjetri, kanë edukuar breza të tërë luftëtarësh me virtytet me të larë ta të popullit tonë. Ato kanë frymëzuar për vepratë guximshme në mbrojtjen e idealeve më të larta kombëtare, duke sfiduar madje edhe fuqitë më të mëdha e më agresive të kohës.

*
* *

Ngjarjet e mëdha që u zhvilluan në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, vrulli patriotik i masave popullore, që shpërtheu si një vullkan i pa-përmbajtur në luftën masive për mbrojtjen e tërësisë tokësore nga lakmitë shoviniste e imperialiste dhe për bashkimin kombëtar në një shtet të vetëm autonom gjatë viteve 1878-1881; kryengritjet e një-pasnijeshme që u zhvilluan gjatë tri dekadave të pastajme kundër ekspeditave ushtarake osmane të komanduara nga vargu i gjatë i pashallarëve gjakatarë turq; rritja dhe kristalizimi i ndërgjegjes kombëtare nën shtytjen e ideve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; përpjekjet e gjithanshme për të shkëputur prangat e robërisë osmane lanë një jehonë të madhe në epikën tonë historike. Përpjekjet dhe luftrërat heroike të popullit shqiptar kundër një koalicioni të tërë armiqsh pasqyrohen gjerësisht dhe flakë për flakë në këngët popullore historike të periudhës së Rilindjes Kombëtare.

Këngët popullore historike të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit janë jehoni e drejtpërdrejtë e përpjekjeve të gjithanshme dhe e luftërave të pabarabarta që bëri populli shqiptar për mbrojtjen e trojeve të veta për liri e pavarezi kombëtare. Tradita popullore, duke i trashëguar nga një brez te tjetri, ka ruajtur dhe përjetësuar në formë artistike kujtimin e atyre ngjarjeve epike, të atyre aspekteve të luftërave për liri të periudhës së Rilindjes.

Poetët popullorë anonimë, duke qenë vetë pjesëmarrës aktivë të këtyre betejave, me krijimet e tyre poetike na japid njoftime të rëndësishme për

ngjarjet e stuhishme, për patriotizmin dhe vrullin luftarak-revolucionar të masave popullore. Në pasqyrimin artistik të ngjarjeve të mëdha historike ata subjektet dhe motivet i morën nga realiteti i jetës, duke bërë një perceptim dhe një vlerësim objektiv të këtij realiteti. Aty vlerësohen virtytet e larta të popullit tonë, i cili nuk kurseu as jetën e vet kur ishte fjala për të këputur prangat e rënda të robërisë osmane, për të mbrojtur tërresinë tokësore nga lakmitë e shteteve shoviniste fqinje dhe të Fuqive të Mëdha imperialiste, për të qenë i lirë dhe i paravarur në trojet e veta dhe për ta çuar jetën përparrë. Njëkohësisht me krijimet e tyre realiste ata stigmatizuan me një forcë dërrmuese shtypjen, shfrytëzimin, përuljen, nënshtrimin, kompromisin, intrigat e tradhtinë e klasave reaksionare, që bashkëpunan me të huajt, dhe iu kundërvunë interesave të larta të popullit e të Atdheut, duke penguar përparimin e kombit.

Këngët popullore historike, me gjithë specifikën e tyre në pasqyrimin artistik të realitetit, në shtresën themelore të tyre përbajnjë elemente me vlerë të madhe për dokumentimin e ngjarjeve historike. Në këngët popullore të këtij cikli, në mënyrë artistike janë fiksuar me vërtetësi palët ndërluftuese, forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë shqiptare të kohës.

Ato, nëpërmjet skenave të veprimeve, vendit, kohës, personazheve kryesore pozitive e negative, fakteve historike na jepin tablo të gjera realiste të ndeshjeve shumë të ashpra e të pabarabarta midis dy kampeve kundërshtare. Këngët historike na jepin botën e brendshme të luftëtarëve popullorë, idealet e mëdha, motivet që frysmezojnë ata për t'u hedhur në llogoret e armikut, duke u flijuar për të-

rësinë tokësore, për bashkimin kombëtar në një shtet autonom, për krenarinë kombëtare, duke mos u gjunjëzuar përpara asnjë force të huaj.

Këngëtarët popullore historike të kësaj periudhe kanë lindur në betejat e luftës popullore kundër pushtuesve të huaj grabitqarë dhe shërbëtorëve të tyre. Këto beteja heroike kanë qenë gjithnjë një burim i pashtershëm fryshtimi për këngëtarët popullore. Autor i tyre është vetë populli, bijtë e thjeshtë të tij: bujq e barinj, burra e gra, luftëtarë aktivë, të cilët kanë luftuar pareshtur për të shpëtuar njëherë e përgjithmonë nga pesha e rëndë e shfrytëzimit ekonomik dhe nga çdo pushtues e zgjedhë e huaj. Ata kanë parë në fushë të betejës bashkëluftëtarët trima që me shumë plagë në trup janë hedhur në grykat e topave të pushtuesve. Qëndresa dhe heroizmi i trimave u përjetësua në këngën e popullit. Ata u bënë simbol burrerie, guximi, trimërie e heroizmi populor duke mbrojtur me gjak traditat, doket, zakonet, gjuhën amtare, dinjitetin kombëtar, çdo pëllëmbë të viseve shqiptare.

Këngëtarët popullorë që jetuan atmosferën e përlleshjeve të përgjakshme, rrjedhimet e ngjarjeve, gjëzimet e fitoreve, hidhërimin e humbjeve të rënda, rënjen në fushën e nderit të bashkëluftëtarëve, shprehin me sinjeritet ndjenjat e tyre të fuqishme, duke krijuar me vargje të kursyera plot fryshtim tablora të gjalla të betejave popullore. Kështu ata kanë përjetësuar virtytet më të larta të të parëve tanë, heroizmin kolektiv, trimat e rënë në fushën e nderit, qofshin ata prijës apo luftëtarë të thjeshtë.

Gjenia krijuese e popullit tonë, me një fryshtim të fuqishëm, me një realizëm të thellë, diti të pasqyrojë jo vetëm në sfond, por t'i ngrejë edhe në re-

liev përpjekjet vigane, vuajtjet e sakrificat e mëdha, fitoret dhe humbjet dhe vëtmohimin masiv të një populli të vogël, por të pamposhtur, i cili, për të realizuar aspiratat e larta për liri e pavarësi, për drejtësi e përparim shoqëror, gjatë të gjithë historisë së vet si moto kryesore ka pasur:

O liri, o vdekje!

*

* * *

Epika historike e periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e pasuroi kulturën tonë kombëtare me temën e mbrojtjes së tërësisë toksore dhe me atë të luftës politike në arenën kombëtare e ndërkombëtare për bashkimin kombëtar në një shtet autonom. Gjinia krijuese ka shprehur në formë artistike virtytet e larta popullore, vitalitetin e popullit tonë, ngjarjet e mëdha politike e luftarake të kohës, nuhatjen e hollë politike, aftësitë luftarake, qëndrimin konsekuent për të gjitha fenomenet historiko-shoqërore.

Ngjarjet e mëdha politike e ushtarake të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shkëlqejnë në historinë tonë kombëtare. Ato na mbushin me krenari e optimizëm, me besim të patundur në forcat tona të pashtershme. Ne dhe brezat pasardhës mburremi për besën, burrërinë, trimërinë, shpirtin luftarak-revolucionar, papërkulshmërinë, heroizmin masiv, për përpjekjet dhe luftërat shumë të ashpra e të pabarabarta të gjyshstërgjyshiérve tanë, që me gjakun e tyre përgatitën dhe sollën popullin tonë në Shpalljen e Pavarësisë kombëtare, në ditën e madhe historike të 28 Nëntorit 1912, ku në Vlorën heroike u valëvit krenar Flamuri i Skënderbeut.

I

«PA U SHKRI N'SHTAT' E N'SHTATËDHETË, ROB ASKUJ NUK MUJMË ME U BA!»

Lidhja Shqiptare, që u themelua më 10 qershor 1878 në Prizren, shënon një nga ngjarjet më të shquara në historinë e popullit tonë. Ajo shënoi një etapë më të lartë në lëvizjen kombëtare shqiptare drejt pavarësisë.

Në kushtet tepër të ndërlikuara të brendshme e ndërkombëtare kur Perandoria Osmane kishte marrë nëpër këmbë të drejtat kombëtare të popullit tonë, kur Fuqitë e Mëdha imperialiste synonin copëtin min e Shqipërisë dhe shtetet ballkanike fqinje kishin zgjatur kthetrat e tyre kush e kush të grabiste më tepër nga viset shqiptare, u formua në Prizren Besëlidhja Shqiptare, që hyri në histori me emrin «Besëlidhja Shqiptare e Prizrenit».

Kjo organizatë e madhe politike-ushtarake që në fillim mori në dorë organizimin dhe drejtimin e luftës shumëfrontëshe që do të bënte populli shqiptar për të mbrojtur me armë në dorë të drejtat e veta kombëtare, tërësinë tokësore të Atdheut dhe për të realizuar bashkimin e tij në shtetin e vet kombëtar.

Lidhja Shqiptare u krijua në kushte historiko-shoqërore të caktuara. Ajo ishte vazhdimi i luftërave heroike që kishte bërë populli ynë gjatë shekujve për liri e pavarësi, për tokën, për gjuhën, për kulturën, për nderin dhe traditat e tij, duke i përcjellë vitet, dekadat e shekujt me kryengritje të stuhishme.

Shtypjes kombëtare e politikës antishqiptare që po ndiqte Perandoria Osmane, duke i mohuar popullit tonë edhe kombësinë, iu shtuan edhe synimet imperialiste të Fuqive të Mëdha evropiane si dhe politika ekspansioniste që po ndiqnin me kokëfortësi shtetet shoviniste ballkanike ndaj Shqipërisë.

Qeveritë shoviniste serbe e malazeze, të etura për grabitje e pushtime dhe të ndërsyera nga Rusia cariste, sulmuan me ushtritë e tyre agresive viset shqiptare në veri dhe në verilindje të Shqipërisë.

Serbia, duke bërë masakra shfarosëse në masë, mbyti në gjak dhe shpërnguli në masë popullsinë vendëse në krahinat shqiptare të pushtuara.

Princi Milan i Serbisë, me qëllim që të përjetësonte pushtimin në krahinat shqiptare, në një urdhër dite, drejtuar trupave të tij agresive që kishin hyrë në viset e banuara prej shqiptarësh, i porosiste forcat e tij shoviniste që: «Sa më tepër shqiptarë të shpërngulni ju me forcë, aq më të mëdha janë meritat tuaja para atdheut»¹). Siç shihet qeveria e Serbisë në planin e saj strategjik kishte shpopullimin e viseve të pushtuara dhe shtrirjen e pushtimit sa

1) Aleks Buda, «Lëvizja popullore, mbi sfondin e së cilës u rrit dhe u zhvillua Rilindja jonë Kombëtare», «Bashkimi» nr. 86, dt. 11 prill 1978, f. 3.

më thellë në tokat shqiptare duke përfshirë Kosovën, Rrafshin e Dukagjinit etj.

Knjaz Nikolla i Malit të Zi me ushtrinë e tij sulmoi viset shqiptare në veri me pikësynim për të shtrirë pushtimin e tij deri në lumin Drin. Mirëpo hovin e ushtrisë agresive malazeze e thyen forcat popullore të viseve të sulmuara. Që nga i riu gjer te plaku, u bënë mur i pakapërcyeshëm dhe, duke luftruar si luanë, frenuan marshimin e agresorëve shovinistë që synonin të pushtonin edhe Shkodrën:

U nis shkjau me bataliona,
në Shkodër desh për me hi,
në Rrezigaqe do asllana,
aty e thyen kuvetin e tij.¹⁾*

Traktati ruso-turk i Shën Stefanit (mars 1878), kur Turqia u mund nga Rusia cariste, zgjeronte shtetet shoviniste fqinje në kurriz të Shqipërisë. Ai «i çonte kufijtë e Bullgarisë, së mbështetur nga Rusia cariste, thellë në tokat shqiptare, përfshirë Tetovën, Gostivarın, Kërçovën, Dilbrën, Strugën, Korçën etj.»²⁾ duke vënë në rrezik tërësinë tokësore të Shqipërisë.

Tërësisë tokësore të Shqipërisë, mbarë popullitet tonë, përpos pushtuesve osmanë që i kishte në truall, tani po i kërcënoheshin si asnjëherë tjetër rreziqe të mëdha, copëtimi i tokave shqiptare, nënshtrimi, skllavërimi, shkombëtarizimi dhe zhdukja e tij si popull e si komb nga harta politike e botës.

* Mali i Zi, ushtria e knjaz Nikollës.

1) Këngë popullore historike, Tiranë 1962, f. 13.

2) «Zëri i popullit» nr. 55, kryeartikull kushtuar 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dt. 5 mars 1978.

Oreksin e qarqeve shoviniste të shteteve fqinje për t'u shtrirë mbi viset shqiptare e ndërsyen për së tepërmi Fuqitë e Mëdha imperialiste të Evropës, veçanërisht Rusia cariste.

Në rrethana tepër të ndërlikuara historike masat popullore rrokën armët për të mbrojtur me gjak trojet e veta dhe të drejtat kombëtare pa pushuar luftën për liri e autonomi.

Për ta shpëtuar kombin nga rreziqet që po i turreshin nga të tëra anët, kërkohej një udhëheqje në shkallë kombëtare. Për këtë qëllim, figurat më të ndritura të popullit shqiptar, vëllezërit Abdyl e Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Zija Prishtina, Hasan Tahsini etj., më 1877 krijuan në Stamboll Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare.

Për t'i shkrirë lëvizjet masive krahinore në një lëvizje të fuqishme kombëtare dhe për ta udhëhequr atë nga një qendër e vetme, nën drejtimin e Komitetit të Stambollit, u krijua organizata e madhe politike-ushtarake, Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Në Kuvendin e madh historik të Besëlidhjes Shqiptare të Prizrenit, frysëzuesi dhe udhëheqësi i shquar politik i Lidhjes Shqiptare, Abdyl Frashëri, midis të tjerash tha:

«Qëllimi i kuvendit është që t'ua presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që t'i mbrojmë me gjak trojet tona që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë». ¹⁾

Kuvendi Kombëtar i Lidhjes Shqiptare, që u

1) Kristo Frashëri, Album kushtuar 50-vjetorit të parësisë, Tirana 1962.

mbajt më 10 qershor 1878 në Prizren, mori përsipër drejtimin e luftës së popullit shqiptar «... për të mbrojtur dhe për të unifikuar tokat shqiptare, kombin shqiptar, për të shpëtuar popullin shqiptar nga robëria e osmanëve, nga robëria e intrigat e fuqive imperialiste, nga shovinistët serbë, malazez, Traktati i Shën Stefanit etj.»¹⁾

Për realizimin e këtyre detyrave themelore Lidhja krijoi në gjithë vendin organizmat e saj drejtuese politike e ushtarake dhe formacionet e armatosura, të cilat do të mbronin me armë në dorë interesat më të larta kombëtare, duke luftuar njëkohësisht si kundër synimeve imperialiste e lakmive shoviniste edhe për bashkimin kombëtar dhe kriimin e shtetit shqiptar autonom.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që në fillim, në përmjet memorandumit që i dërgoi përfaqësuesit të Anglisë në Kongresin e Berlinit, kryeministrit Dizraeli, në emër të popullit shqiptar u bëri të ditur Fuqive të Mëdha, shteteve shoviniste fqinje, dhe botës mbarë se populli shqiptar do të mbronte me gjak çdo pëllëmbë të trojeve të veta dhe njëkohësisht do të luftonte deri në fund për të shkëputur prangat e robërisë, për të rifituar lirinë e grabitur, të drejtat kombëtare të marra nëpër këmbë dhe theksonte se shqiptarët janë «...të gjithë ushtarë, të mësuem ndër rreziqe e të forcuem në të gjitha mundimet e luftës»^{2).}

Memorandumë të tillë Lidhja u dërgoi përfaqë-

1) Enver Hoxha, Fjala e mbajtur në mitingun e madh në Gjirokastër, «Zëri i popullit» dt. 17 mars 1978.

2) Pëllumb Karkanaqe, «Jemi të gjithë ushtarë», gazeta «Drita» nr. 15, dt. 9 prill, 1978.

suesve të Fuqive të Mëdha dhe Portës së Lartë gjatë gjithë periudhës trevjeçare të saj.

Memorandum proteste iu dërguan Fuqive të Mëdha dhe Portës së Lartë dhe nga komitetet e degëve të Lidhjes nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, si p.sh. nga Kosova, Dibra, Shkodra, Ulqini, Vlora, Gjirokastër, Plava e Gucia, Çamëria, etj. etj.

Fuqitë e Mëdha evropiane, duke ndjekur një politikë imperialiste, nuk përfillën zérin e fuqishëm të njërit nga popujt më të vjetër në Evropë. Ato, për të kënaqur interesat e veta imperialiste dhe lakinjtë e klikave shoviniste të shteteve ballkanike, që po ndiqnin një politikë të ethshme ekspansioniste në kurriz të Shqipërisë, në Kongresin e Berllinit vendosën copëtimin e tokave shqiptare, duke u dhënë shteteve shoviniste fqinje krahina të tëra shqiptare.

Poeti popullor me një krenari kombëtar, me besim të patundur në forcën e armëve dhe të trimërisë shqiptare, paralajmëron Fuqitë e Mëdha që të mos luanin me fatet e popullit shqiptar, se «*ka trimëtra Shqipëria*» dhe do të gjenin atë që nuk e prisin:

Frenk), e gjeç nga njerëzia,
se së' humbi Shqipëria.*

*harruat Shqipërinë,
q'i ka trimat si shahinë!¹⁾*

Vendimet historike të Besëlidhjes Shqiptare, që shprehnin thellësisht aspiratat e mbarë popullit

*) Ka parasysh |Fuqitë e Mëdha.

1) Këngë trimërie, botim i MMP, Tiranë, 1968, f. 75.

shqiptar të etur për liri e pavarësi dhe për përparim shoqëror, u përhapën me shpejtësinë e rrufesë. Në të katër anët e viseve shqiptare menjëherë u krijuan degët e Lidhjes dhe pranë tyre repartet e armatosura për të mbrojtur tokat shqiptare nga synimet imperialiste e lakmitë e shovinistëve fqinjë, duke luttuar njëkohësisht deri në fund për autonomi territoriale-administrative,

Pas epokës së lavdishme të Skënderbut, për herë të parë, në shkallë kombëtare, i gjithë populli shqiptar, i bashkuar rreth Lidhjes Shqiptare, po jetonte çastet e një bashkimi të fuqishëm luftarak, të një patriotizmi të flaktë, të një ndjenje të lartë të detyrës ndaj Atdheut të robëruar, që po i kërcëno-heshin copëtimi e zhdukja.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që i pat rrënjet e saj të thella në vetë popullin që e lindi, në luftërat e tij të pareshtura kundër pushtuesve osmanë për liri e pavarësi, drejtësi e përparim dhe tanë kundër synimeve imperialiste të Fuqive të Mëdha dhe lkmive të shteteve shoviniste fqinje i dha popullit shqiptar të parin program politik e ushtarak në shkallë kombëtare dhe caktoi strategjinë e taktikën e saj. Ajo hodhi themelët e një kryengritjeje popullore të organizuar, ku populli shqiptar si një trup i vetëm rroku armët dhe luftoi me vëtmohim njëkohësisht në dy fronte: kundër pushtuesve osmanë, që i kishte në truall, dhe kundër lkmive të shteteve shoviniste fqinje, prapa të cilave qëndronin Fuqitë e Mëdha imperialiste, të cilat po ndiqnin një politikë të egër imperialiste agresive antishqiptare.



*
* * *

Lidhja Shqiptare me në krye udhëheqësit më besnikë, largpamës e konsekuentë si Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi etj. zhvilloi një luftë shumëfrontështë si në fushën politike ashtu dhe në atë ushtarake

Kjo lëvizje e fuqishme politike e ushtarake që la vulën e vet në epikën tonë historike, na thotë poeti anonim, alarmoi për së tepërmë dhe vuri në lëvizje diplomacinë e Fuqive të Mëdha imperialiste dhe shtetet shoviniste fqinjë.

Pa zgjatje e stërhollime, me pak vargje të daltuarë, si me një komunikatë ushtarake, poeti popullor na jep shqetësimin dhe alarmin e «shtatë krajlave» që «rrahin telin», mblidhen me ngut e komplotojnë kundër interesave më të larta, më jetike të popullit tonë:

*Të shtatë krajlat rrahin telin:
— Koka mbledhë tanë Prizreni!*)*
*Të shtatë krajlat kuvendojnë:
— Prizreni**) çka po thonë?¹)*

Përpjekjet e gjithanshme të Lidhjes Shqiptare në fushën politike, për t'ua bërë të njohur shteteve imperialiste të Evropës vendimet e Besëlidhjes Shqiptare, vendosmërinë e popullit shqiptar për të mbrojtur tërësinë tokësore, të drejtat e veta kombëtare, poeti popullor na i mishëron në figurën e ndri-

*) tërë Shqipëria.

**) Shqipëria.

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 15-17.

tur të udhëheqësit politik të Lidhjes Shqiptare, Abdyl Frashërit.

Populli ynë, i përfaqësuar nga organi i tij më i lartë, që ishte Lidhja Shqiptare, ngre zërin kundër vendimeve grabitqare të Kongresit të Berlinit. Zëri i tij i fuqishëm, pa lutje e nënshtrim, nëpërmjet përfaqësuesit të vet, ushton nëpër kryeqytetet e mëdha të Evropës dhe në atë të Perandorisë Osmane.

Poeti na thotë se Abdyl Frashëri, që ishte «*burri i Shqipnisë*» largpamës e konsekuent, i ra kryq e tërthor tërë Shqipërisë. Ai organizoi kuvende popullore të Besëlidhjes Shqiptare që nga Prizreni deri në Gjirokastër, Përmjet e gjetkë. Ai, vënë në dukje këngët, për të mbrojtur aspiratat më të larta kombëtare shkruat gjithë aftësitë e tij mendore e fizike, pasurinë e tij, çau dete dhe ngriti zërin e fuqishëm të protestës të popullit shqiptar në Berlin, Vjenë, Paris, Romë e Stamboll. Abdyl Frashëri vajtideri në Berlin, për t'i thënë Bismarkut se Shqipëria nuk ishte «një shprehje gjeografike», siç e kishte quajtur ai, po një realitet historik.

Abdyl Frashëri, na tregon kënga, paralajmëroi Fuqitë e Mëdha imperialiste që të mendoheshin «*mire*» përpëra se të vendosnin për ta bërë Shqipërinë «*copa-copa sikur s'ka njeri*», se atë do ta mbrojnë me armë në dorë bijtë e bijat e saj deri në pikën e fundit të gjakut.

Kënga thotë:

*Jemi vetëm shqiptarë
dhe duam liri;*

*të rritur n'ata male,
me libra n'gji.¹⁾*

Në pak vargje, në mënyrë të sintetizuar, poeti nxjerr në relief se shqiptarët, ndonëse të pushtuar, kurrë nuk u janë nënshtuar pushtuesve të huaj, po me armë në dorë, duke përballuar stuhitë e shekuve, kanë ruajtur traditat e zakonet, gjuhën e kulturën e vet kombëtare, duke mbajtur gjithnjë gishtin në këmbëz dhe librat në gji. Prandaj ata luftojnë për liri e pavarësi, se janë «*vetëm shqiptarë*», dhe nuk do t'i nënshtrohen asnje force në botë.

Me këto vargje poeti hedh poshtë të gjitha shpifjet e propagandës antishqiptare të Fuqive të Mëdha imperialiste, të qarqeve shoviniste fqinje dhe të Portës së Lartë, që identifikonin besimin fetar me kombësinë dhe që e quanin popullin shqiptar të pakulturë e të paaftë për t'u vetëqeverisur.

Prologu i përlleshjeve të përgjakshme trevjecare kundër këtij koalicioni armiqsh agresorë qenë bëtjet popullore që u zhvilluan në Gjakovë (2-6 shtator 1878) kundër të dërguarit të Portës së Lartë, marshal Mehmet Ali Pashë Maxharit. Atë e kishte ngarkuar Stambolli për të detyruar Lidhjen Shqiptare të Prizrenit që të mos kundërshtonte diktatin e Fuqive të Mëdha të Evropës, por t'uva dorëzonin shovinistëve malazez krahinat shqiptare, sipas Traktatit të Kongresit të Berlinit.

Mehmet Ali Pashë Maxhari, posa arriti në Prizren (25 gusht 1878), ushtroi presion mbi kryesinë e

1) «Këngë popullore historike», Tiranë 1962, f. 24.

Lidhjes Shqiptare, duke i kërkuar asaj që populli shqiptar duhet t'i nënshtrohej pa kushte diktatit të Fuqive të Mëdha evropiane.

Kur disa feudalë turkomanë, që qëndronin në udhëheqje të Lidhjes Shqiptare, iu nënshtruan të dërguarit të Stambollit, masat popullore të vetarmatosura rrëthuan selinë e Lidhjes, kërkuan largimin e pashait osman nga Kosova dhe përjashtimin e besëshkelësve nga kryesia e Lidhjes Shqiptare. Si përgjigje të presionit e të kërcënimit të Stambollit forcat e Lidhjes vranë në Prizren telegrafistin e të dërguarit të Portës së Lartë.

Protestat kundër Portës së Lartë, e cila iu nënshtrua vendimeve të Kongresit të Berlinit, dhe vrajsja e telegrafistit, shënojnë fillimin e shpërthimit të një stuhie të re të popullit shqiptar.

Poeti populor, duke shprehur aspiratat më të larta kombëtare të popullit shqiptar të udhëhequr nga Lidhja e Prizrenit, e paralajmëron Portën e Lartë dhe i drejtohet sulttanit me mllef:

Sulltan, mos dëgjo Frëngjinë),
na s'lëshojmë Shqipërinë,
nuk qasim Malëzinë,
as Sérbinë, as Grekërinë,
na duam autonominë!¹⁾)*

Kështu filluan goditjet e para masive me armë ndaj Portës së Lartë. Zemërimi i papërmabjtor i popullit kryengritës po shpërthente si një stuhi. Mehmet Ali Pasha, i frikësuar nga gjendja e krijuar, kér-

*) Fuqitë e Mëdha imperialiste.

1) «Këngë trimërie», botim i MMP, Tiranë 1968, f. 74.

koi përforcime nga Mitrovica dhe i shoqëruar nga një batalion ushtarësh turq, me 31 gusht u largua nga Prizreni për në Gjakovë.

Pashai i Stambollit shkoi në Gjakovë tek Abdulla Pashë Dreni, i cili, ndonëse ishte në udhëheqje të Lidhjes, e mori nën mbrojtje armikun e popullit shqiptar.

Udhëheqësit e Degës së Lidhjes të Gjakovës, patriotët e shquar, Sulejman Vokshi, Ahmet Kornica etj., pa përfillur vendimin e Fuqive të Mëdha, e pa u trembur nga kërcënimet e Portës së Lartë dhe autoriteti i feudalëve turkomanë si Abdulla Pashë Dreni, që shkeli Besëlidhjen Shqiptare duke marrë nën mbrojtje të dërguarin e Stambollit, hodhën poshtë ultimatumin e Stambollit dhe qitën kushtrimin anembanë krahinës së Gjakovës.

Ardhja në Gjakovë e të dërguarit të sulltanit dhe kërcënimet e tij ngritën në këmbë jo vetëm popullsinë e qytetit, por edhe popullsinë e Malësisë së Gjakovës, të Rekës dhe të Hasit, e cila po qëndronte e gatshme me armë në dorë për të mbrojtur tokat shqiptare.

Në përgjigje të kushtrimit që dha Komiteti i Degës së Lidhjes të Gjakovës: «*O hiq kush t'jesh, se ka ardh' ni murtat, Mehmet Ali Pash Maxhari, me na çart besën* (Besëlidhjen Shqiptare të Prizrenit — M. M.) *me lshue Plavë e Guci e me na marrë shkau krejt!...*» sipas traditës luftarake për mbrojtjen e trojeve të veta, kryengritësit, të vendosur për të mbrojtur Besëlidhjen dhe vendimet e Lidhjes Shqiptare, rrokën armët «*n'shtatë e n'shtatëdhjetë» vjeç. Kështu, më se 3800 kryengritës nga qyteti, Malësia e Gjakovës, Reka e Hasi, nën drejtimin e udhëheqësve popullorë, si Sulejman Vokshi, Ahmet Ko-*

ronica, Ali Ibra, Mic Sokoli etj., u vërsulën si një ortek dhe rrrethuan kullat e tradhtarit Abdulla Pashë Dreni, ku pashai i Stambollit kishte mbledhur rrreth vetes disa krerë turkomanë pér t'ia kundër-vënë Besëlidhjes Shqiptare,

Forcat popullore kryengritëse *lidhën besë* që jo vetëm të dërguarin e Stambollit me shtabin e tij, por, sipas traditës, asnjë nga besëshkelësit e Lidhjes Shqiptare të mos e lëshonin të gjallë. Ndonëse kulla e Abdulla Drenit ruheshin nga 6 kompani ushtarësh, kryengritësit, mbasi prenë linjat telefonike, paralajmëruan të dërguarin e Stambollit dhe strehu-sin e tij, Abdulla Pashë Drenin, që, në qoftë se nuk largohen nga Gjakova brenda 24 orësh:

*Me i pasë kraht' me fluturue,
gjallë prej kulle s'ju lamë me shkue...¹⁾*

Sa e lartë ishte vetëdija kombëtare dhe sa e thellë ishte ndjenja e detyrës ndaj Atdheut na dëshmon rrrethimi i hekurt nga «*djelt e mimleqetit*»*) i «*ni murtati*»**) qı coj dovleti» dhe i tradhtarit shqiptar që i doli në mbrojtje pashait të Stambollit.

Dega e Lidhjes e Gjakovës në emër të popullit shqiptar kryengritës paralajmëroi të dërguarin e sulltanit që të hiqte dorë nga çdo kërcënim e presion pér ta bindur e nënshtruar Lidhjen që të zbatonte vendimet e Kongresit të Berlinit, ndryshe do ta paguante me kokë. Po pashai osmanlli nuk hoqi dorë. Sulmi i furishëm i kryengritësve mbi armikun e boshkëpunëtorët e tij të mbrojtur nga forca të shumta turke ishte i pandalshëm.

1) «Pér vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 15.

*) e popullit

**) tradhtari

Njëri nga kryengritësit e thjeshtë popullorë, luftëtari trim, i vendosur dhe besnik, Daut Dërguti nga Shipshani, kërkesës së Abdulla pashë Drenit për t'u hapur një shteg kalimi ose për t'u dhënë një kovë ujë për të pirë kundrejt një shpërblimi me një trajcë florinj, ai i përgjigjet në mënyrë të vendo-sur me një sarkazëm dërrmuese se «*as për një thes me florinj nuk të jap një trajcë dhé të vatanit tem, as një kovë ujë të krojeve tonë, o murtat!»**)

Në portat e avllisë së kullave të Abdulla Pashë Drenit u vendosën «trimat e çartun», si Col Delia i Gegëhyzenit, Ahmet Sadria i Shipshanit etj. etj. Më 2 shtator filloi sulmi i furishëm, i cili vazhdoi për 4 ditë e net pa ndërprerje deri në fitoren e plotë mbi armiqjtë.

Rrethimi, sulmi i furishëm i kryengritësve, vrama e luftës popullore mbi të dërguarin e sulltanit e bashkëpunëtorët e tij, të mbrojtur nga forca të shumta turke dhe qëndresa e papërkulur e forcave popullore u pasqyruan gjërisht e flakë për flakë në epikën historike të asaj kohe, me tërë heroikën e dramacitetin e tyre, duke nxjerrë në pah madhështinë e luftës popullore.

Vrasja e Mehmet Ali pashës në Gjakovë, këtij përfaqësuesi të Perandorisë Osmane, ishte një akt i guximshëm politik e ushtarak jo vetëm kundër Portës së Lartë, por njëkohësisht dhe një kundërgoditje e vendosur që Lidhja Shqiptare e forcat e saj të armatosura i dhanë me grykë të pushkës Traktatit të Shën Stefanit dhe vendimeve grabitqare të Kongresit të Berlinit. Populli shqiptar tregonte kështu se ai ishte i vendosur për të realizuar detyrat them-

*) Arkivi i muzeut historik Tropojë.

lore të Lidhjes Shqiptare, duke mos u trembur përpara asnjë fuqie agresive sado e madhe të ishte ajo. Ai ishte i bindur se me forcën e armëve të bashkuara, i udhëhequr nga Lidhja Shqiptare, do të triumfonte mbi pushtuesit osmanë dhe do të thyente edhe agresorët shovinistë, prapa të cilëve qëndronin Fuqitë e Mëdha imperialiste.

Si rrjedhim i ngjarjeve të Gjakovës, në këtë krahinë organet qeveritare turke u zëvendësuan menjëherë me nëpunës shqiptarë, besnikë të Lidhjes, të cilët gjëzonin besimin e popullit kryengritës.

Në betejat e Gjakovës, përvçe Mehmet Ali Pashë Maxharit dhe strehuesit të tij, Abdulla Pashë Drenit e disa krerëve që u bashkuan me të, nga të dy palët mbetën të vrarë e të plagosur afro 1000 vetë, midis të cilëve Col Delia nga Gegëhyseni, Daut Dërguti dhe Alush Alia nga Shipshani së bashku me qindra të tjera. Ata ranë në fushën e nderit për interesat e larta kombëtare, duke u radhitur në vargut e gjatë të të rënëve për mbrojtjen e tërësinë tokësore dhe për thyerjen e zgjedhës barbare osmane.

Këngët popullore që flasin për zhvillimin e këtyre ngjarjeve na jepin njoftime të hollësisht përmisionin me të cilin e kishte dërguar Porta e Lartë Mehmet Ali Pashën.

Me një varg të kursyer, me një ironi të hollë, populli demaskon përpjekjet e ethshme të Portës së Lartë për të zbatuar Traktatin e Berlinit, mision me të cilin qe ngarkuar Mehmet Ali Pasha. Aty gjejmë kërcënimet e këtij pashai kundrejt Lidhjes Shqiptare, bashkëpunimin e Portës së Lartë «*me shtatë krajli*» për copëtimin e tokave shqiptare. Poeti vë

në pah kryengritjen e popullit shqiptar, rrrethimin e pashait të Stambollit në kullat e Abdulla Pashë Drenit, sulmin e furishëm të forcave të armatosura të Lidhjes, fundin tragjik ku u katandis i dërguari i Stambollit dhe përkrahësi i tij, tradhtari Abdulla Pashë Dreni:

*Be po ban mbreti m'ka çue,
nji hudut*) për me vndue,
në kishë të Deçanit, në gur të shpue!¹⁾*

Ai me një sarkazëm therëse zbulon dhe demaskon politikën imperialiste antishqiptare që po ndiqnin Fuqitë e Mëdha të Evropës dhe lëshimet që Porta e Lartë po u bënte fuqive imperialiste, në kurri të Shqipërisë së pushtuar, duke cunguar tërësinë e saj tokësore:

*Të shtatë krajlat kuvendojnë:
— Prizreni shka po thonë?
— Ni murtat na e çoi dovleti,
shkoi në Xhakovë te Abdulla Begi.
Kish pasë gisht me shtatë krajli,
lyp hudutin çok n'Malsi.
Aj hajduti koftë i zi,
çiti futat shpi për shpi;
shpi për shpi, mahall' e n'mahall,
bini djem, ju dhashtë e marë!²⁾.*

Me mprehtësi politike poeti popullor vë në të njëjtën shënjetër si fuqitë imperialiste të Evropës,

*) Kufirin

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 15.

2) Po aty f. 17.

që vendosën copëtimin e tokave shqiptare, po ashtu edhe Perandorinë Osmane, që ishte vënë në shërbim të Traktatit grabitqar të Berlinit.

Populli kryengritës, na thotë poeti, është betuar që:

*Me i pasë kraht me fluturue,
gjallë prej kulle s'ju lamë me shkue;
gjallë prej kulle pashën s'e lamë,
s'e lamë pashën kurr' për t'gjallë!¹⁾*

Poeti popullor me pak vargje na tregon se si besëshkelësit e Lidhjes Shqiptare të tipit të Abdulla Pashë Drenit për interesat e tyre feudale u kundërvihen popullit dhe interesave më të larta kombëtare.

Me vargjet e tij ironike, të vëna në gojën e Abdulla Pashë Drenit, poeti popullor na tregon se feudalët turkomanë janë gati që tradhtinë e tyre ta përligjin duke e maskuar atë me zakonin patriarkal të «besës»:

*«S'un e lshova unë çet mik,
se po m'ja nzanë djalit sytë,
po m'i thonë: «Baba t'u ka koritë»...²⁾*

Kundër qëndrimit turkoman të feudalit shqiptar, shohim qëndrimin e vendosur të masave kryengritëse, të cilat vërshojnë e sulmojnë, duke mos përfillur asnjë lloj fuqie apo autoriteti. Masat popullore, besnikë të interesave më të larta të Atdheut, nuk njo-

1) Po aty, f. 15.

* luftëtarët popullorë

2) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 15.

hin asnë forcë apo autoritet veç Lidhjes Shqiptare, që përfaqësonë plotësisht aspiratat e tyre.

Kryengritësit popullorë kishin vetëm një besë, atë që i kishin dhënë Atdheut, për interesat e të cilit do të kacafyteshin me «të shtatë krajlat e mretin» dhe do të flijoheshin «si me le». Prandaj e paralajmërojnë armikun dhe bashkëpunëtorin e tij:

— *Priti djelmt' e mimleqetit,*)*
*t'u kanë rrasë në derë t'haremit**)...¹⁾*

Dhe trimat hidhen në sulm me atë guxim e trimëri që i ka karakterizuar gjithmonë shqiptarët kur ka qenë puna për mbrojtjen e idealeve të tyre më të larta në luftërat e pareshtura për liri e pavarësi.

Me vargje sarkastike, të vëna në gojën e të dërguarit të sulttanit, të cilin e kishte kapluar tmerri nga zjarri i luftës popullore, poeti anonim shfrym millefin e përgjithshëm të popullit kryengritës kundër Portës së Lartë:

Maxhar Pasha rrin mendue:
— *Kush e rreh' i tel për mue?*
babë dovletit me ja çue,
se n'Xhakovë më kanë rrethue,
më kanë mshelun porsi grue...²⁾

Kryengritësit, besnikë të idealeve të larta kom-bëtare dhe të vendosur për të mbrojtur vendimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, janë të pamëshirshëm

*) e popullit,

1) Po aty, f. 15.

**) dhoma ku rrinë gratë e shtëpisë.

2) «Për vend tonë jem tuaj luftue», Tiranë 1968, f. 15-16.

jo vetëm ndaj pushtuesit, por edhe ndaj tradhtarëve të tipit të Abdulla Drenit, që, për ofiqe e grada, për çifligje e lavdi personale, janë gati të shesin edhe atë që populli ka më të shtrenjtë, Atdheun, për mbrojtjen e të cilit masat popullore, «fukaraja», nuk kanë kursyer as bukën e fëmijës, as gjakun.

Prandaj poeti anonim, duke shprehur urejtjen e thellë të popullit shqiptar me një sarkazëm therëse, dërrmuese, i drejtohet tradhtarit:

— *Qysh ke njeh, yzbashi mret,
fukaranë pse po ma shet? ...¹⁾*

Kryengritësit hidhen në sulm. Pa përfillur breshëritë e armëve të forcave armike të armatosura gjer në dhëmbë, ata hidhen sipër mureve të larta të avllisë dhe në oborr të kullave kacafyten me forcat osmane dhe bëjnë batërdinë mbi to. Një nga luftëtarët popullore, Col Delia i Malësisë së Gjakovës, i cili bashkë me mijëra malësorë të tjerë që «në maje të bjeshkës janë kanë mësue/ ujt e keq mos me kërkue», me qëndrimin e tij burrëror, përpara rënies në fushën e nderit, i entuziazmuar nga vrama e luftës popullore kundër përfaqësuesit të Portës së Lartë dhe bashkëpunëtorëve të tij, u drejtohet shokëve:

— *Bini, shokë, lumtu krahi!
vet po jes, pashën po e çarti...²⁾*

Kullave të renegatit u vunë flakën. Pashanë e

1) Po aty, f. 16.

2) Murat Paci, dëshmor i LNC (dorëshkrim) mbledhur në janar të vitit 1935 në Malësi të Gjakovës (sot rrëthi Tropojë).

Stambollit dhe bashkëpunëtorin e tij, Abdulla Pashë Drenin, i pushton lemeria.

Luftëtarët sypatrembur me ndërgjegje të lartë janë të gatshëm të flijohen në çastin vendimtar për idealin e përbashkët; nëpërmes flakës e zjarrit ata futen në kullën ku pashanë osman e kishin «*mshe-lun posi grue*». Col Delia, mbasi e rrëzon përtokë pashanë e Turqisë, bie si trimat në fushën e nderit. Po ai bashkë me dhjetëra e dhjetëra trima të tjerë të Lidhjes bie dhe mbetet në këngën e popullit si një yll i pashuar i guximit, i trimërisë dhe i vetmohimit kolektiv. Ai simbolizon kështu papërkulshmérinë e popullit të thjeshtë që është i vetëdijshëm për sakrificën që bën për interesat jetike kombëtare.

Poeti anonim, duke vënë vargjet e tij sarkastike në gojën e hanëmes së pashës, që e ka pushtuar lebetia, na tregon për fundin tragjik të pashallarëve:

*Hanm' i pashës del në shkallë:
— Kuku, sot për pashallarë!
Hanm' i pashës ç'po pisket:
— Rrihnja telin babës mret,
Ali Pashën ç'ta ka xhetë.
në ni hu të paska metë.¹⁾*

Forcat kryengritëse të Lidhjes nuk ngurruan për t'u dhënë dënimin e merituar jo vetëm të dërguarit të Sulltanit dhe përkrahësit të tij, që shkeli Besëlidhjen Shqiptare, po edhe disa krerëve të tjerë, të cilët iu nënshtruan autoritetit të Abdulla Pashë Drenit, u vunë në mbrojtje të pashait të Stambollit, u ndanë nga populli dhe shkuant kundër interesave të

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 15.

larta kombëtare. Por «*djelt e mimleqetit*» ishin besatuar pér të mbrojtur trojet shqiptare, Atdheun e shtrenjtë me çdo sakrificë, me pikën e fundit të gjakut, duke mos u têrhequr pérpara çdo presioni, e force agresive. Ata nuk i ulin armët as pérpara kercenimit të «*dovletit*», as pérpara diktatit të Fuqive të Mëdha, as pérpara vringëllimit të armëve të agresorëve shovinistë, sepse janë të ndërgjegjshëm pér detyrën e lartë ndaj Atdheut. Prandaj me vetdije të thellë politike, me ndërgjegje të lartë patriotike e luftarake kombëtare, u ngritën mbi konceptin e ngushtë të zakonit «*të besës e bujarisë*» dhe treguan se me të vërtetë shqiptari është trim, bujar e besnik deri në vdekje, por «*për të pabesin besë nuk ka!*». Shqiptari përmbi të gjitha ka vetëm një besë, besën që i ka dhënë Atdheut.

Këngëtari popullor, duke shprehur aspiratat më të larta të popullit kryengritës ndaj çështjes kombëtare, nënvizon vendosmërinë e patundur të popullit shqiptar pér të mbrojtur çdo pëllëmbë të trojeve të veta. Këtu ai thekson dhe nxjerr në pah motivin e mbrojtjes së tërësisë tokësore të Atdheut sipas vendimeve të Besëlidhjes Kombëtare Shqiptare:

... *Ja k'dhanë besën Dukagjinit,
mos me ia lshue tokat llatinit,*)
tokë llatinit mos me i lanë,
pa e mbush vorre an' e m'anë!*¹⁾

Me një forcë të madhe përgjithësuese, në vargjet e tij të fuqishme, të derdhura si në bronz, poeti

*) pushtuesit

1) «Këngë popullore historike», Tiranë 1956, f. 213.

popullor jo vetëm përjetëson guximin e trimërinë e popullit shqiptar, triumfin e forcave popullore të Lidhjes mbi agresorët, por paralajmëron Portën e Lartë dhe të gjithë koalicionin e armiqve të shumtë lakmitarë se:

*Kshtu Shqipnija kish pasë adet,
ka ni pashë me e mytë për vjet!*¹⁾

Vrasja e Mehmet Ali Pashës, manifestimet e triumfit të popullit kryengritës me kokën e pashait të Stambollit në hû, parullat e hedhura kundër Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha imperialiste që vendosën copëtimin e tokave shqiptare, ishin përgjigjja më e vendosur që populli shqiptar, i bashkuar si një trup i vetëm rrëth Lidhjes së tij kombëtare, u dha Portës së Lartë, shovinistëve fqinjë dhe Fuqive të Mëdha të Evropës. Njëkohësisht këto ishin paralajmërimi i një gjendjeje politike shumë të ngarkuar, që pritej të shpërthente si vullkan i papërmabjatur kundër sundimit mesjetar osman.

Betejat e përgjakshme e fitimtare të Gjakovës entuziazmuani dhe frymëzuan pa masë patriotët e shquar shqiptarë që banonin jashtë Atdheut, të cilët luftonin pareshtur për lirinë e pavarësinë e Atdheut. Këtyre ngjarjeve të stuhishme patrioti e poeti i madh, De Rada, u bëri më vonë jehonë të gjerë në revistën «*Fjamuri i Arbërit*».

Duke dashur t'i bëjë të njojur mbarë opinionit botëror rritjen e ndërgjegjes kombëtare, bashkimin

1) Po aty, f. 213.

e fuqishëm politik e luftarak në shkallë kombëtare, vendosmërinë e popullit shqiptar për të mbrojtur me gjak trojet e veta dhe për të luftuar pareshtur për liri e pavarësi kombëtare, De Rada, më 1883, botoi këngët popullore kushtuar ngjarjeve të Gjakovës. Në to pasqyroheshin gjerësisht dhe plot vërtetësi historike këto ngjarje të stuhishme, që çorientuan Fuqitë e Mëdha dhe Portën e Lartë. Nëpërmes epikës historike, De Rada i bëri të njohur opinionit botëror, se populli shqiptar, ndonëse i vogël dhe me pushtuesin osman në truall, pati guxim që të barabitej me një koalicion të tërë armiqsh, duke hedhur poshtë me grykë të pushkës vendimet imperialiste grabitqare të Kongresit të Berlinit.

Jehona e këtyre ngjarjeve si brenda ashtu edhe në arenën botërore qe shumë e madhe. Ato ngritën lart moralin e popullit shqiptar dhe thelluan shumë diferencimin politik të forcave në radhët e lëvizjes kombëtare për mbrojtjen e tokave shqiptare dhe për bashkimin kombëtar në një shtet kombëtar autonom. Feudalët turkomanë po lëkundeshin. Manifestimet antiosmane në Shqipëri, veçanërisht në krahinat e Shqipërisë së Veriut e të Verilindjes, shqetësuan për së tepërm Stambollin. Ushtarët shqiptarë, që ishin mobilizuar me forcë, po dezertonin në masë. Kudo nëpër Shqipëri kërkohet që në kushtet e reja kur Atdheut po i kërcënohej copëtimi, Perandorisë Osmane të mos i paguheshin taksat dhe të mos i jepe-shin ushtarë, por gjithçka të përdorej për mbrojtjen e tokave shqiptare nga kërcënimet e shovinistëve fqinjë. Kërkohet që detyrën e ruajtjes së rendit publik e të qetësisë ta merrte vetë Lidhja dhe

të krijoheshin edhe gjykatat shqiptare me nëpunës vendës, të cilat të gjykonin sipas normave zakonore shqiptare.

Gjendja luftarake e krijuar në Shqipëri, e veçanërisht në Rrafsh të Dukagjinit e në Kosovë, alarmoi për së tepërmi qarqet shoviniste të shteteve fqinjë si dhe fuqitë imperialiste. Diplomacia e Fuqive të Mëdha të Evropës ndoqi për së afërmë e plot shqetësim zhvillimin e tyre. Përfaqësuesit konsullorë austro-hungarezë dhe rusë, francezë, anglezë etj. nga Prizreni, Shkodra etj. u raportonin qeverive të veta se në Gjakovë pushteti është në dorën e shtresave më të «ulëta» të popullit, çka i shtynte ata ta krahasonin gjendjen e krijuar në atë trevë me Komunën e Parisit.¹⁾

Betejat e Gjakovës shënojnë fillimin e përlleshjeve të armatosura me koalicionin e armiqve grabit-qarë. Këto beteja ngritën më lart ndërgjegjen politike kombëtare të popullit tonë, zgjeruan e thelluan lëvizjen e fuqishme trevjeçare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në luftën thikë më thikë për tërësinë tokësore dhe për bashkimin e popullit shqiptar në një shtet autonom kombëtar.

Këto detyra themelore qysh në fillim u shkrinë në një të vetme. Mbledhja e gjerë e Lidhjes Shqiptare, që u themelua në Prizren, në fillim të nëntorit 1878 miratoi memorandumin që i dërguan Portës së Lartë, ku në emër të popullit shqiptar kërkohej njojha e kombësisë shqiptare dhe e drejta e bashkimit të të gjitha viseve shqiptare në një shtet të vetëm autonom, të qeverisur nga vetë shqiptarët.

Porta e Lartë, e trembur nga shpërthimi i kryen-

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 142.

gritjes së stuhishme, vrasjen e të deleguarit të saj, Mehmet Ali Pashës, hëpërhc e la në heshtje dhe, për të fituar kohë, i mbajti kryengritësit me premtimë mashtruese.

Lidhja i kuptonte dredhitë tradicionale të Portës së Lartë, por ishte e mobilizuar për mbrojtjen e viseve të kërcënua nga shovinistët fqinjë.

Ushtima e këtyre ngjarjeve në epikën historike të periudhës së Lidhjes Shqiptare zë një kapitull të veçantë. Aty mbizotëron ideja për të mbrojtur me armë trojet shqiptare dhe për të fituar autonominë.

Këto na i thotë poeti anonim pa mëdyshje:

Na s'e lëshojmë Shqipërinë,

*Na duam autonominë!*¹⁾

1) «Këngë trimërie», botim i MMP, Tiranë 1968, f. 74.

«Të paharruara do të mbeten betejat legjendare të shqiptarëve që për tre vjet me radhë mbrojtën me gjoks Plavën e Gucinë, Hotin, Grudën e Ulqinin, duke u bërë kështu një sfidë të pashembullt fuqive perëndimore, që kishin vendosur t'ia shkëputnin ato Shqipërisë. Vështirë, shumë vështirë e patën patriotët tanë dhe në këtë drejtim. Prandaj për sigurimin e atdheut të lyre ata përdorën të gjitha mjetet, që nga armët e deri te veprimet e zgjaura diplomatike. Këto të fundit ata i praktikuau në rastet më të ndryshme, me qëllim që të manovronin në situatat e krijuara, të gjenin aleatë, të shfrytëzonin kontradiktat midis fuqive të ndryshme për shembjen e Turqisë, për shkatërrimin e komploteve të fuqive të huaja kundër Shqipërisë dhe për çlirimin e plotë të saj»¹⁾.

ENVER HOXHA

1) Enver Hoxha, vepra, vëll. 24, Tiranë, 1977, f. 11.

II

«ME GAZETA VESH E KAM MARRË,
SE KREJT SHQIPNIA BESËN KA LIDHË...»

Për të kundërshtuar politikën imperialiste të Fuqive të Mëdha, të cilat vendosën copëtimin e tokave të Shqipërisë, dhe për të përballuar çdo agresion nga shtetet shoviniste ballkanike dhe kërcënimet e Portës së Lartë, Lidhja Shqiptare jo vetëm protestoi në mënyrë të vendosur pranë Fuqive të Mëdha dhe Portës së Lartë, por shpalli mobilizimin e përgjithshëm dhe mori masa të ngutshme për organizimin e forcave të armatosura popullore.

Në të katër anët e viseve shqiptare Degët e Lidhjes organizuan repartet e armatosura.

Për të mbrojtur krahinat shqiptare që kërcëno-heshin, rrökën armët të gjithë meshkujt e aftë përluftë, kurse femrat morën përsipër të përballonin të gjitha punët bujqësore e blegtorale, ushqimin e vesh-mbathjen e forcave të armatosura, duke garantuar një prapavijë të sigurtë. Kështu femra shqiptare u vu krah për krah me burrin dhe dha një kontribut të shquar për fitoren politike e ushtarake të Lidhjes Shqiptare mbi koalicionin e armiqve agresorë.

Në kuadrin e përgjithshëm të përpjekjeve dhe të luftërave trevjeçare që bëri populli ynë për mbrojtjen e tërësisë tokësore, për bashkimin kombëtar dhe për krijimin e shtetit autonom shqiptar një vend të veçantë zënë betejat e përgjakshme, që zhvilluan forcat e armatosura popullore të Lidhjes për mbrojtjen e Plavës, Gucisë, Hotit, Grudës, Kelmendit e Ulqinit.

Këto beteja të përgjakshme që iu imponuan popullit shqiptar, janë të ngjeshura plot me situata epike. Aty dalin në relief virthitet më të larta të popullit tonë: dashuria e pakufishme për vendin, urejtja e thellë kundër lakmive të shovinistëve të panginjur malazez, si edhe kundër «shtatë krajlave» e «dovletit» që bënin tregti me trojet tona.

Betejat për mbrojtjen e tërësisë tokësore u bënë objekt i krijimtarisë poetike popullore dhe zgjuan e ndezën fantazinë e popullit tonë, i cili diti jo vetëm të mbrojë me burreri, guxim, trimëri e vëtmohim trojet e veta, por edhe të përjetësojë heroikën e këtyre ngjarjeve në këngën e vet epike. Poeti anonim, i frysmezuar nga realiteti i ngjarjeve, diti të na japë me aq vërtetësi historike, me mjeshtëri të rrallë artistike dhe me një forcë të madhe përgjithësuese të gjithë kuadrin e këtyre përlleshjeve shumë të ashpra e të pabarabarta.

Këngët popullore të kësaj periudhe na zgjerojnë informacionin historik. Ato na jepin njoftime të sakta mjaft të hollësishme për përpjekjet e ethshme të të gjithë koalicionit të armiqve për të copëtuar e gllabëruar tokat shqiptare, nga ana tjeter vendosmërinë e popullit shqiptar, të forcave të armatosura të Lidhjes, për të mbrojtur çdo pëllëmbë të trojeve të veta. Njëkohësisht këngët e këtij cikli na tregojnë

për gjendjen shpirtërore të forcave popullore të Lidhjes dhe të udhëheqësve popullorë që u qëndronin besnikë idealeve të masave popullore, çështjes së lartë kombëtare. Ato stigmatizojnë ashpër jo vetëm agresorët shovinistë, Fuqitë e Mëdha imperialiste e Portën e Lartë që ndjek një politikë antishqiptare, po edhe qëndrimin e lëkundshëm të disa bejlerëve, pashallarëve e klerikëve reaksionarë që luhaten dhe që për interesat e tyre të ngushta kalojnë në anën tjetër të barikadës, duke u bërë vegla qorre e shërbëtorë të të huajit.

Këngët popullore historike të kësaj periudhe nxjerrin në pah qëllimet grabitqare të qarqeve politike e ushtarake shoviniste malazeze, me knjaz Petroviçin në krye, për të pushtuar tokat shqiptare të paktën deri në Drin. Ato na tregojnë përgatitjet e ethshme ushtarake të knjaz Nikollës, i cili, duke pasur përkrahjen e fuqisë imperialiste, e posaçërisht të Rúsisë cariste sllavomadhe, përgatit dhe sulmon viset shqiptare me më se 12 mijë forca ushtarake të komanduara nga vojvoda Mark Milani (Mark Harambashi), Teodori i Ri etj. Poeti na tregon për nisjen e forcave agresive në drejtim të Plavës e Gucisë, rrëthimin e Velikës, Nikshiqit e Beranit, djegien e ~~kafë~~ kullave në kufirin verior si edhe qëndresën burrërore të luftëtarëve shqiptarë si Kadri Bejri i Rugovës së Pejës etj., të cilët që në përpjekjet e para u bënë barrikadë e pakalueshme për agresorët shovinistë malazez.

Populli i krahanës së Plavës e të Gucisë dhe ai i Rugovës, të njojur për guxim e trimëri, nuk u trembën nga agresorët, por i vunë gjoksin frontit dhe gozhduan forcat armike në vend:

*Të del dielli e prenon hana,
Zhuj Selman nuk ban ma nana,
hin në kullë, pisket si zana:
— Merrnje vesh, o kapetana,
merrnje vesh, kallzoni Zekit,
s'i lshoj kullat e Sheremetit!¹⁾*

Luftëtarët trima si Zhuj Selmani, Sali Jaha, Rexhë Avdia, Isuf Mujani, Zhuj Kasemi etj., na thotë poeti, u ngulën në kufij përballë forcave të shumta agresive malazeze dhe u flijuan «*si me le*».

Këngët historike na tregojnë se si knjaz Nikolla i Malit të Zi, ky shovinist i etur për pushtime, u drejtohet shqiptarëve për t'i lëshuar Plavën e Gucinë dhe krahinat e tjera shqiptare, të premtuara nga Fuqitë e Mëdha, sipas traktatit të Kongresit të Berlinit:

*— Gjashtë copë shehre mreti m'i ka falë,
t'shtat' krajobraz për hair m'i kanë ba,
a po çohesh shehret me m'i lëshue,
ja se sherrin kie me ma pa!²⁾*

Poeti populor, duke vënë vargjet e tij në gojën e Petroviç knjazit, demaskon synimet shoviniste të qarqeve politike e ushtarake malazeze për pushtimin e krahinave shqiptare, pazarllëqet e turpshme të Fuqive të Mëdha të Evropës, të cilat ndiqnin një politikë imperialiste, antishqiptare dhe politikën me dy faqe të Portës së Lartë, në kurriz të Shqipërisë. Përpjekjeve djallëzore dhe kërcënimeve shovinisto-

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 29.

2) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

-imperialiste populli ynë, i udhëhequr nga Lidhja Shqiptare, u jep një përgjigje të vendosur:

*Pa u shkri n'shat' e n'shtatëdhetë,¹⁾
rob as kuj nuk mujmë me u ba.²⁾*

Përgjigja e prerë që Lidhja Shqiptare i dha knjaz Nikollës të Malit të Zi, na thotë poeti, shkaktoi hutim dhe alarm të madh te shovinistët malazez.

Kënga popullore na tregon gjendjen e rëndë shpirtërore të knjaz Nikollës, përgatitjet e ethshme ushtarake, njëkohësisht panikun e pasigurinë që mbretëron në udhëheqësit e lartë ushtarakë e shtetorë të Malit të Zi për të realizuar qëllimet e tyre shoviniste.

Të gjithë këtë kuadër poeti anonim na e jep me art nëpërmes vetë gojës së armikut:

*— Kadit, knjaz, un be kam ba,
me shqyptarë luftë s'kam me ba;
gjithsaherë me ta si kam luftue,
gjithmon sherrin jau kam pa.³⁾*

Kënga na thotë se si i përgjigjet prerasi knjaz Nikollës, njëri nga princat malazez, Pop Milan Vuki, i cili refuzon të marrë komandën e ushtrisë shoviniste malazeze në luftë kundër forcave të Lidhjes Shqiptare, duke deklaruar, sipas një varianti, se:

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

2) Qemal Haxhihasani, «Përpjekjet e popullit shqiptar për liri», Tiranë 1962, f. 305.

3) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 19.

*Njiqind mij asqer me m'i dhanë,
s'muj me i marrë Plavë e Guci...¹⁾*

Shumë kuptimplotë është edhe përgjigjja që i jep knjaz Nikollës një princ tjetër malazias, gospodin Bozha. Kënga popullore nxjerr në pah jehonën e madhe që kishte bërë Besëlidhja Shqiptare e Prizrenit në arenën botërore.

Te Besëlidhja Shqiptare qarqet shoviniste fqinje shikonin pengesën e pakapërcyeshme për t'ia arritur qëllimit. Prandaj poeti anonim thekson panikun, hутimin e pasigurinë që kishte shkaktuar bashkimi luftarak i popullit tonë rrëth Lidhjes Shqiptare:

— *Me gazetë vesh e kam marrë,
se krejt Shqipnija besë ka lidhë,
se ata e kanë besën pa prishë;
shtatë krajlat ndihmë me na dhanë,
na n'u mujmë me hi në Plavë.²⁾*

Në këto vargje poeti popullor me mprehtësi politike, duke shprehur besimin e patundur të popullit shqiptar në forcat e veta, nxjerr në pah edhe thekson rëndësinë historike dhe vendimtare të unitetit, të bashkimit luftarak të popullit tonë në Besëlidhjen Shqiptare të Prizrenit. Ai shpreh bindjen se populli shqiptar, duke qenë i bashkuar si një trup i vetëm, ndonëse pa asnjë përkrahje nga jashtë, është në gjendje të përballojë të gjithë koalicionin e armiqve. Prandaj ai thekson forcimin e Besëlidhjes Shqiptare, ruajtjen e saj si dritën e syve, sepse kun-

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendorur.

2) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 19-20.

dër kësaj Besëlidhjeje i kishin drejtuar shigjetat e helmatosura i gjithë koalicioni i armiqve agresorë. Poeti popullor thekson se te ky unitet kombëtar, te ky bashkim luftarak qëndron e gjithë forca vendimtare e popullit shqiptar në luftën e tij pér mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut, pér të fituar lirinë e pavarësinë kombëtare.

Knjaz Nikolla i Malit të Zi, i pushtuar nga lakinëtë shoviniste dhe i egërsuar nga qëndresa e patundur e popullit shqiptar, komandën e forcave malazeze ia beson njërit prej gjeneralëve më gjakatarë, Mark Milanit, i cili e pranon atë me mburrje, duke vringëlluar armët.

Në dialogun që zhvillohet midis knjaz Petroviçit dhe Mark Milanit kënga nxjerr edhe një herë në pah se knjazi tani e kishte të qartë se ai kishte të bënte jo vetëm me krahinën e Plavës e të Gucisë, por me të gjithë Shqipërinë. Megjithatë ai nuk mund të hiqte dorë nga pretendimet e tij të çmendura, sepse mbështetej direkt në ndihmën e Fuqive të Mëdha evropiane dhe në mobilizimin e Portës së Lartë pér zbatimin e traktatit antishqiptar të Kongresit të Berlinit:

— Me Shqipni luftë domë me ba,
gjashtë copë shehre mbreti m'i ka falë.
— Dymbëdhjet'mij asker me m'i dhanë,
un t'i marr Plav' e Guci,
edhe i marr Pejn e Gjakovën,
n'Prezren lavdin' ta ngrehi...¹⁾

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

Burimet historike dhe variante këngësh popullore të kësaj periudhe na tregojnë se Mark Milani bashkë me 12 mijë¹) forca malazeze të zgjedhura dhe të armatosura deri në dhëmbë, në fillim të tetorit të viti 1879 sulmoi krahinën e Plavës e të Gucisë.

Poeti anonim na tregon se Mark Milani, me gjuhën e agresorit e të pushtuesit shovinist, i kërçenohet dhe i dikton popullit të Plavës e të Gucisë:

*Mark Milani i Malit t'Zi,
— Merr vesh Plavë, merr vesh Guci:
Ta due sillen n'xhami,
Drekën n'Plavë, darkën n'Guci!
— Prim aty, se due me ardhë!
Në kishë t'Deçanit due me dalë!
Se mue mreti m'i ka falë,
t'shtat krajlat m'i kanë ba për hair.²)*

Qëllimin strategjik të shovinistëve malazez, për t'u shtrirë sa më shumë në trojet tonë, sulmin e tyre agresiv, bashkërendimin e Portës së Lartë me fuqitë imperialiste për zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, poeti popullor e zbulon me shkathësi nëpërmjet vargjeve të vëna në gojën e vetë Mark Milanit.

Sulmit të pabesë të shovinistëve malazez, na thotë poeti anonim, krahinat e sulmuara iu përgjigjën si gjithnjë me grykë të pushkës. Ato hodhën kushtrimin për të gjitha grykat, që nga Rrafshi i Dukagjinit e deri në Shkodër.

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 156.

2) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

Zëri i kushtimit përhapet me shpejtësinë e rru-fesë:

*Në katër anët potera ka krisë:
n'Dukagjin potera m'a qitë:
e para potere në Grykë të Pejës paska krisë,
edhe e dyta në Grykë të Deçanit,
ajo e treta në Grykë të Dragobisë...¹⁾*

Dhënien e kushtimit poeti popullor e paraqet me ngjyra të forta emocionale dhe mobilizuese. Ai na tregon gjendjen kritike, kërcënimin e vendit nga agresorët shovinistë, marshimin e tyre drejt trevave shqiptare.

Poeti anonim, pasi na thotë se «*sheher n'sheher letrat i kanë shkepë, / i kanë qitë në Rekë e n'Mal-si, / n'tana anët potera ka krisë*», na tregon përmobilizimin e përgjithshëm të forcave popullore të Lidhjes, përmblodhjen te Verrat e Llukës, përmbesëlidhjen e forcave shqiptare, të cilat janë betuar që «*pa u shkri n'shtat' e' shtatëdhetë*» vjeç mos me i lëshue trojet e veta, Plavën e Gucinë e krahinat e tjera, që synonin përmblodhjen e forcave popullore të Lidhjes së Pejës e të Gjakovës, që u mbledhën te Verrat e Llukës, lajmëruan popullin e krahinës së Plavës dhe të Gucisë se ato ishin të gatshme përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë.

Forcat popullore të Lidhjes së Pejës e të Gjakovës, që u mbledhën te Verrat e Llukës, lajmëruan popullin e krahinës së Plavës dhe të Gucisë se ato ishin të gatshme përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë. Poeti popullor nxjerr në pah veprimtarinë e organizuar të degëve të Lidhjeve të Pejës e të Gjakovës përmblodhjen e forcave shqiptare nga agresorët shovinistë.

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

osman i kishte katandisur në një det të thellë mjerimi: pa bukë në gojë, pa rroba në trup, pa opinga në këmbë. Por në trupin e tyre të zhveshur e të zbatthur, të pangopur me bukë, rreh një zemër e madhe, e çeliktë, e pamposhtuar, që nuk di se c'është frika. Ata, na thotë kënga, mbi çdo gjë vënë interesat e larë ta të Atdheut, prandaj janë të vendosur që të shkrihen të tërë, por asnjë gisht tokë të mos ia lëshonin askujt:

— Veç gjashtë ditë n'mujshi me qindrue,
fukaraja opingat sa t'i mbarojnë,
i madh e i vogël qatje dom' me dalë,
dom' me dalë e dom' me u coptue,
gjallë s'ia lshojmë Plavën as Gucinë!¹⁾

Pikërisht te këta njerëz të thjeshtë e kishte djenin dhe truallin e saj të patundur vendosmëria, guximi, trimëria dhe vetmohimi i pashoq. Tek ata gufonte dashuria e pakufishme për vendin, urejtja e thellë për pushtuesit.

Forcat popullore të degëve të Lidhjes të Gjakovës e të Pejës të udhëhequra nga Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka etj. u mblohdhën te Verrat e Llukës dhe përpara se të niseshin për Plavë e Guci i dërguan një ultimatum (masbadë) sulltan Hamidit. Forcat e Lidhjes hidhnin poshtë kërcënimet e Portës së Lartë dhe e paralajmëronin atë për një qëndresë të vendosur jo vetëm për mbrojtjen e tokave shqiptare, por edhe për të fituar autonominë:

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tirani 1968, f. 19.

— Me tokë teme mreti çka ka?¹⁾
 tan kah Plava kan' t'fillue;
 se Marki sonte n'kufi ka dal!²⁾)
 për tri grykat rrugën e kan' marrë,³⁾
 i pari t'mramin hiç s'e pret,
 kiet*) n'mal vetëm i kan' lan',
 ka pesë për shpi**) po shkojnë.⁴⁾

Në Kuvendin e Madh të Besëlidhjes Shqiptare të Prizrenit populli shqiptar ishte betuar që «tokën e babs mos me e lshue, / rob askujt mos me ju bâ».

Për të mbrojtur tërsinë tokësore nga agresorët e tërbuar «tan Shqipnia n'kufi â dalë!...», na thotë poeti. Kështu që në fillim, midis forcave popullore shqiptare të krahanave të sulmuara dhe atyre shoviniste u zhvilluan përpjekje të ashpra në Pepiq, në Velikë, në Nevshok etj.

Mijëra luftëtarë të Lidhjes nga Rrafshi i Dukagjinit, nga Malësia e Gjakovës, Hasi dhe nga krahanat e Shkodrës vrapuan për t'u prerë hovin agresoreve dhe për t'i shporrur nga trojet tonë.

Forcat e armatosura të Degës së Lidhjes të Pejës dhe asaj të Gjakovës vrapuan nëpër grykën e Pejës e të Deçanit, kurse ato të Malësisë së Gjakovës e të Hasit të Thatë nëpër grykë të Llukave e të Dragobisë përmes Alpeve të larta e me borë.

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

2) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 19.

3) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

*) qetë

**) në luftë

4) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 21.

Forcat popullore të Lidhjes, me të arritur në Qafë të Diellit, në Qafë të Vranicës, të Borit e te Kershi i Mujkut, sipër Plavës e Gucisë, për të ngritur moralin e popullit të krahinave të sulmuara, dhe për të paralajmëruar forcat armike që të mos luanin me zjarrin e luftës popullore, sipas traditës, arritjen e tyre e lajmëruan me një breshëri pushkësh dhe pis-kame, jehona e të cilave u përplas përkarshi në Qafë të Previsë:

*Permi Plavë kur janë dalë,
gjysa e natës koka kenë,
ni denam*) e paskan ba.*

U ka dalë para Jakup Feri.

*— Ja mrrini Peja me Gjakovë,
janë me ta Malsi e Rekë.*

kia janë ardhë me ne me dekë...¹⁾

Arritjen e rrufeshme të forcave të armatosura të Lidhjes në Plavë e në Guci, vendosjen e tyre përballë forcave agresive malazeze dhe qëndrimin e tyre për shtatë javë rresht në mbrojtje pozicionale, poeti popullor e shpreh me vargje lapidare, të vëna këto, në gojën e vetë luftëtarëve. Duke shprehur ndjenjën e lartë të detyrës karshi Atdheut, poeti nxjerr në reliëf vendosmërinë e tyre, qartësinë e qëllimit, besimin në fitore, gatishmërinë për t'u fliuar, sepse ata njëzëri ishin betuar që:

*Tokën e babës s'mujm me e lshue,
pa e mush vorre anë e man'!...²⁾*

*) breshëri armësh

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

2) Po aty.

Betimi solemn i tetë mijë¹⁾ luftëtarëve popullorë të Lidhjes ishte betimi solemn i mbarë popullit shqiptar, i cili, i armatosur për vetëmbrojtje, po qëndronte vigjilent karshi fqinjëve të tjerë shovinistë dhe kishte drejtuar mendjen, sytë e zemrën e tij te kra-hina e sulmuar e Plavës dhe e Gucisë.

Këtë vendosmëri të pashoqe, këtë bashkim të fuqishëm politik e luftarak, këtë besim të patundur në forcën e armëve të veta të bashkuara, këtë moral të lartë të mbarë popullit shqiptar dhe të luftëtarëve të Lidhjes në vijën e frontit verior, poeti na e jep me një forcë të madhe përgjithësuese nëpërmes vargjeve të vëna në gojën e vetë udhëheqësit ushtarak të forcave agresive shoviniste malazeze, Mark Milanit, i cili, i pushtuar nga paniku, që nga vija e frontit e njofton Petroviç knjazin në Cetinë, se:

*Krejt Shqipnija n'kufi â dalë,
e druksi shteki*) se n'Cetinë do të na vijnë²⁾*

Poeti popullor na tregon për gjendjen e rëndë shpirtërore të Petroviç knajzit. Ai tani e sheh të pamundur pushtimin e Plavës e të Gucisë. Prandaj, si shërbëtori zotërisë, u ankohet dhe u kërkon ndihmë padronëve të vet, Fuqive të Mëdha:

*N'u po don qytetet me m'i lshue,
drue ngatrresa se n'kufi po bahet.³⁾*

1) Historia e Shqipërisë, II, Tiranë 1965, f. 156.

*) këtë radhë

2) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 22.

3) Po aty, f. 22.

Porta e Lartë u gjend përpara presionit të fortë të fuqive imperialiste, veçanërisht të Perandorisë cariste, të cilat i kërkonin zbatimin e Traktatit të Berlinit. Mirépo vendosmëria e popullit shqiptar për të mbrojtur trojet e veta dhe ultimatumi që i dërgoi sulltanit populli i Pejës e i Gjakovës, e vunë midis dy zjarresh Stambollin. Për t'i dalë së keqes përpara, Porta e Lartë u vu në lëvizje të ethshme. Kështu sulltani dërgoi si komisar të lartë në Kosovë Ahmet Muhtar Pashën me forca të shumta për të detyruar luftëtarët e Lidhjes Shqiptare dhe popullin e armatosur që të tërhiqeshin nga krahina e Plavës dhe e Gucisë, duke ia lëshuar ato Malit të Zi:

*Njizet mijë ushtarë me i marrë,
Shqipnisë mrenë për me i shkue¹)*

Sulltani e ngarkon mareshalin e Perandorisë Osmane që me forcën e armëve t'i detyrojë forcat popullore shqiptare të Lidhjes të tërhiqen dhe të shpërndahen, duke iu nënshtruar pa kushte diktatit të Fuqive të Mëdha dhe të Portës së Lartë lidhur me vendimet antishqiptare që mori Kongresi i Berlinit.

Mareshal i Stambollit, na tregon poeti, posa *amiti* në Prizren me hordhitë e tij të shumta, i kërcënoi forcat e armatosura të Lidhjes me një sulm pas shpine:

*N'Prizren pasha tek â dalë,
i letër t'bardhë e paska shkrue,
gjith parisë ja u ka çue:*

1) Qemal Haxhihasani, vepër e përmendur, f. 275.

— Kthehuni n'shpija për me shkue,
ja se mbrapa luftën pa ja u nisi,
se kto shehre mbreti ja ka lshue.¹⁾

Forcat e armatosura të Lidhjes Shqiptare, na thotë kënga, të vendosura për të mbrojtur trojet e veta, që nga vija e frontit për mbrojtjen e Plavës e të Gucisë, i japid një përgjigje krenare, të vendosur e dërrmuese dhe këtij të dërguari të sulltanit:

«Lut fat se jam qillue n'Plavë,
se shum ma zi se Maxharit ta kisha ba!
Me tokë teme mreti çka ka?
tokën teme askurrkuj nuk ja lshoj,²⁾
— N'pacim ymer prej shpie me u dredh,
ma zi se knjazit kam me ta ba!³⁾

Përgjigjja që i dhanë forcat e Lidhjes të dërguarit të Perandorisë Osmane ishte tërë barut e flakë. Ajo paralizoi të 20 mijë forcat osmane, të cilat i kishte dërguar sultani për të shtypur me zjarr e hekur çdo kundërshtim e qëndresë të popullit shqiptar. I trembur se mos pësonte fatin e paraardhësit të tij, Mehmet Ali Pashës në Gjakovë, mareshali Ahmet Muhtar Pasha, ndonëse po i kërcënonte kryengritësit me një sulm pas shpinës, e ndali marshimin në drejtim të Plavës e të Gucisë. Ai nuk guxoi t'i godiste forcat e armatosura të Lidhjes dhe as të marshonte në drejtim të tyre.

1) Murat Paci, dorëshkrim i përmendur.

2) Po aty.

3) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1963, f. 22.

*Ka marrë pasha letrën me e këndue,
tri herë vedin n'letër qen po e sheh,
mirë po e din se pa luftë s'don' me lshue!...¹⁾*

Në këto vargje të fuqishme sarkastike poeti popullor shpreh shumë qartë urrejtjen e thellë të popullit shqiptar ndaj Portës së Lartë. Porta e Lartë, në vend që të kundërshtonte me armë copëtimin e tokave shqiptare, ishte vënë politikisht e ushtarakisht në shërbim të agresorëve të tërbuar.

Të 8 mijë forcat popullore të Lidhjes u gjetën midis dy zjarresh: përballë 12 mijë forcave agresive malazeze dhe 20 mijë forcave osmane. Megjithatë forcat e Lidhjes nuk u trembën as nga vrangëllimi i armëve të shovinistëve malazez, as nga kërcënimet e forcave turke, as nga diktati e presioni i Fuqive të Mëdha imperialiste. Edhe në këto çaste shumë kritike dhe vendimtare përfatet e Atdheut, forcat e Lidhjes dhe mbarë populli shqiptar qëndruan si një mal i pamposhtur.

Forcat e Lidhjes u betuan se agresorët malazez, gjallë a vdekë do t'i shporrrnin nga tokat shqiptare. Mirëpo vendosmëria e tyre ndeshi edhe në lëkundjet, kapitullimin, kompromisin, diversionin dhe në tradhtinë e disa feudalëve turkomanë, që po e pengonin kundërmësymjen e forcave të Lidhjes.

Por forcat popullore, «vegjëllimi», siç e quan poeti, duke parë se si disa krerë reaksionarë, «parsimi», kishin ngrënë paratë e armikut dhe kishin tradhtuar interesat e larta të Atdheut, në bashkëveprim me prijësit më besnikë popullorë, si Sulejman Vokshi, Haxhi Zeka, Jakup Feri, Ali Ibra, Isuf So-

1) Po aty, f. 22.

koli, Mic Sokoli, Mulla Jaha etj., pa përfilluar autoritetin e feudalëve, vendosën të hidheshin në kundërmësymje për t'u treguar shovinistëve malazez dhe të gjithë koalicionit të armiqve se çdo pëllëmbë e trojeve tona zot të vërtetë kishte vetëm bijtë e saj e askënd tjetër:

*Tanë vegjlimi rrugën ja u ka zanë:
— Se sot' ni javë s'kem' me pritë,
kur t'niset drita me dalë,
luftën Markit do t'ia nisim!¹)*

Qëndrimit të lëkundshëm e tradhtar të feudalëve dhe të bejlerëve çifligarë poeti popullor i vë përballë patriotizmin e flaktë, qëndrimin e vendosur, frymën luftarake, shpirtin sulmues, vrullin e pandalshëm të masave popullore të vegjëlimit, që kanë shkuar «me dekë» e «tokën e babës» mos «me e lshue», «pa u shkri të tanë». Prandaj, pa përfillur kërcënimet e të gjithë koalicionit armik dhe të shërbëtorëve të shitur, forcat popullore të Lidhjes u hodhën menjëherë në kundërmësymje kundër agresorëve malazez për t'i shporrur ata nga tokat shqiptare:

*Ndiu parsimi e para u ka dalë,
po don djelt për me i ndalë;
kurrkush djelt s'ka mujtë me i ndalë.
— Udhë e mbrapshtë, djelvë u kanë thanë,
në dashtë zoti e rob po ju zen,
se kurnja mbrapa s'kem me u ardhë!²)*

Forcat ushtarake të Lidhjes, që ishin përqën-

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 22.

2) Po aty, f. 23.

druar në Plavë e në Guci dhe në fshatrat përreth, po ndiqnin me vigjilencë veprimtarinë e «parsimit» që po i mbante këto forca në pritje, duke e zvarritur kundërmësymjen me pretekstin se «nuk kemi fishekë», «sa të bajmë planet e luftës» etj.

Luftëtarët popullorë e kuptuan se disa krerë po i bënин bisht kundërgoditjes. Prandaj ata, të udhëhequr nga kryetrimat më besnikë, vendosën që me të gdhirë (janar 1880) të hidheshin në sulm kundër forcave të shumta armike.

Të nesërmen, posa zbardi dita, forcat popullore u nisen nga Plava e Gucia në drejtim të Urës së Plavës për të kaluar në anën tjetër të lumbit Lim*). Mirëpo ura ishte zënë nga bejlerët e «parsimi», të cilët nuk lejuan të kalonin luftëtarët popullorë. Ata organizuan një provokacion shumë të rrezikshëm, nga i cili mund të shpërtihente në çast një vëllavrasje e tmerrshme, që do t'u shërbente drejtpërdrejt agresorëve.

Në këto rrethana tepër kritike, për t'iu shmanjur vëllavrasjes, e cila do të ishte fatale për forcat popullore të Lidhjes, një ndër luftëtarët popullorë të Malësisë së Gjakovës, Adem Selmani vetë i tretë, e la urën dhe u hodhën për të kaluar Limin me not. Menjëherë pas tyre vërvshuan të gjitha forcat e tjera, të cilat, pa përfillur kërcënimin e disa krerëve reaksionarë, as të ftohtët e madh në acarin e janarit, kaluan me not në anën e përtejme të Limit.

Forcat popullore, mbasi kaluan lumin e Plavës e dolën në të majtë të rrjedhjes së Limit, u mblodhën në Brezovicë. Aty u vendos që forcat e Lidhjes të sulmonin në dy drejtime: një grup forcash

*) Lumi që buron nga liqeni i Plavës.

do të sulmonin në të djathtë të rrjedhjes së Limit, në drejtëm të Velikës, ndërsa forcat e tjera do të sulmonin në të majtë të rrjedhës së Limit, në drejtëm të Viçitorrit.

Sipas Zakonit tradicional të malësorëve, sulmi nisi me piskamë dhe këngë dhe me një breshëri pushkësh.

Përleshja midis forcave të Lidhjes dhe agresorëve filloi në afërsi të Velikës, Viçitorrit dhe Pepiqit. Forcat shoviniste malazeze, me gjithë epërsinë e tyre në njerëz dhe në armatim, përballë kundërsulmit të furishëm dhe rrebeshit të luftës popullore të forcave të Lidhjes, u gjendën krejtësisht të pafuqishme. Përleshjet qenë shumë të ashpra. Ato për orë të tëra u zhvilluan trup më trup.

Poeti anonim, duke folur për vramën e luftës popullore të forcave të Lidhjes, për hedhjen e tyre dallgë-dallgë në llogoret e armikut dhe për përleshjet fyt më fyt, na tregon për panikun, frikën e hutimin që kishte përfshirë komandantin e forcave agresive:

*Mark Milani po ban seri,
tridhet' krena na i preu ni njeri,
si i thankan Jakup Feri!¹⁾*

Beteja të përgjakshme, thikë më thikë, u zhvilluan në të dy anët e lumit të Limit në afërsi të fshatrave Velikë e Pepiq. Të 12 mijë forcat shoviniste, të shpartalluara plotësisht, në një panik të thellë, u detyruan të braktisin fushën e betejës, duke lënë shumë të vrarë, të plagosur dhe të mbytur në lumin e Limit.

Një vëzhgues diplomatik austro-hungarez, duke

1) Arkivi i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor Tropojë, Kujtime nga veteranët.

vlerësuar betejat e janarit të vitit 1880, thoshte se: «Fuqia e Lidhjes e theu atë ushtri malazeze që ka qenë kurdoherë e zonja t'u bëjë ballë ushtrive turke. Shqiptarët, — nën vizonte ai, — luftuan të shtyrë nga ideja kombëtare». ¹⁾

Forcat ushtarake të Lidhjes, duke mbrojtur trojet e veta të shenjta, u dhanë një mësim të mirë jo vetëm agresorëve shovinistë malazez, por me grykë të pushkës paralajmëruan edhe shovinistët e tjerë fqinjë që të mos luajnë me zjarrin.

Fitorja e forcave ushtarake të Lidhjes mbi ato malazeze ishte një paralajmërim tjetër si për Fuqitë e Mëdha ashtu edhe për Portën e Lartë, që po ndiqnin një politikë të tërbuar antishqiptare.

Zhvillimin e betejave të përgjakshme, triumfin e bujshëm të forcave të Lidhjes, shpartallimin e plotë të agresorëve shovinistë, kufomat e të cilave nxinë ujérat e Limit dhe i skuqën ato deri në Taslixhe e në Vishegrad, rapsodi popullore na i jep nëpërmjet një ironie të hollë. Me vargun e tij të fuqishëm ai na tregon fundin e turpshëm të forcave agresive malazeze dhe dëshpërimin e madh të Mark Milanit. Ai, i tronditur nga shpartallimi i plotë i ushtrisë së tij, mbasi del jashtë rrezikut duke shpëtuar lëkurën e vet, i vëtmuar si korbi i zi në Qafë të Previsë, nxjerr kujën për disfatën e turpshme të ushtrisë së vet:

*Duel Milani në Previ,
shikon Limin me turbi:
— Ç'ka ka Limi si duket zi?*

1) Qemal Haxhihasani, vepër e përmendur, f. 275.

*Hajmedet vojnikt' e mi!
— Ç'ka ka Limi si duket gjak?
Nu' po i çon trupat fort larg,
deri n'Taslixhe e Vishegrad!¹⁾*

Poeti popullor, i frymëzuar nga triumfi politik e ushtarak i forcave shqiptare të Lidhjes mbi ato shoviniste, me një krenari të ligjshme, na tregon se po ai Mark Milan që dikur, i dehur nga lakmitë shoviniste, i pat premtuar me bujë knjaz Nikollës në Cetinë, se «*me m'i dhanë mue 12 mij, / sillen e ha n'Plavë, darkën n'Guci*», tanë, i dërrmuar nga grushti vdekjeprurës që hëngri në fushën e betejës si dhe nga frika që i ka hyrë në palcë, betohet solemnisht se: «*kurr sefer si lypi ma Shqipnisë!*».

*A dalë Marki opet n'Previ:
— Ni myhlet, mori Shqipni,
prej sabahit deri n'qindi,^{*)}
sa ta kcej<sup>**) Qafn e Previsë,
po t'baj bé n'kryq të kishës,
kurr sefer^{***)} si lypi ma Shqipnisë!^{!2)}</sup>*

Poeti anonim na jep hollësira për humbjet e mëdha dhe disfatën e armikut. Ai me dhimbje të thellë na tregon se, për të korrur këtë fitore mbi agresorët, popullit shqiptar iu desh përsëri të njomë trojet e veta me gjakun e dhjetëra e dhjetëra bijve më të mirë:

1) Q. Haxhihasani, vepër e përmendur, f. 276.

*) në darkë

**) ta kaloj

***) si shpalli luftë, nuk e sulmoj.

2) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 26.

*Sa e kcyen Plavën, n'Nakshiq po don' me hi,
janë përpjek*) në Mulla Jahan,
krejt i kuq prej gjaku ish kanë,
tri varrë t'idhta Jaha i kish marrë,
— A din gja, Jah, me na kallxue?
— Si â ma mirë për ne â bâ:
treqind krena i kemi xerrë,
dymbëdhetë mijë n'Lim ja kem mbytë,
njëqind vet sod na kanë mbetë.¹⁾*

Poeti popullor, duke qenë ndoshta vetë pjesë-marrës i atyre betejave ose në ushtimën e menjë-hershme të ngjarjeve epike, thekson qëndrimin e prerë dhe të hapët antiosman të forcave të Lidhjes. Pasi na tregon se populli shqiptar është zot i trojeve të veta dhe do t'i mbrojë ato deri në pikën e fundit të gjakut, bën fjalë për ultimatumin (mazbadën) që i dërguan nga mbledhja e Verrave të Llukës forcat e Degës së Lidhjes të Pejës dhe të Gjakovës drejtpërdrejt sulltanit gjakatar:

*Ni letër të bardhë e paskan shkrue,
gjith myhyrët**) n'ta i kanë vndue,
ia kanë çue sultani Hamitit:
— Ti shëndosh për Pejë e Gjakovë,
pasha i zot po to je met,
çì i ke lshue Plavë e Guci...²⁾*

*) ndesh, takuar.

1) Murat Paci, material i përmendur.

**) firmat, vulat.

2) Po aty.

Në këto vargje tingëllon me forcë zëri i protestës, urrejtja e thellë e grumbulluar prej shekujsh në gjirin e masave popullore shqiptare kundër puschuesve osmanë. Këtu poeti, duke u bërë interpret i ndjenjave të mbarë popullit shqiptar, demaskon prapaskenat politike antishqiptare të Portës së Lartë dhe tregon se populli shqiptar është i vendosur jo vetëm për të mbrojtur tërësinë tokësore nga synimet shoviniste e imperialiste, por ai nuk do ta pushonte luftën derisa të shkëpuste zinxhirët e robërisë së egër osmane.

Poeti popullor i tregon sulttanit gjakatar se këtë radhë ka mbetur pa Shqipërinë, se populli shqiptar me hir ose pahir do të fitojë autonominë:

Sulttan, mos dëgjo Frëngjinë,)
na s'lëshojmë Shqipërinë,
nukë qasim Malëzinë,
as Sérbin, as Grekërinë,
na duam autonominë!¹⁾*

Këto e shumë vargje të tjera të asaj periudhe, të cilat i qëndruan kohës, janë një dëshmi e gjallë autentike që hedhin poshtë mendimin e pseudoshkencëtarëve reaksionarë shovinistë të vendeve fqinje etj., të cilët kanë pohuar më se një herë se gjoja Lidhja Shqiptare e themeluar në Prizren ka qenë e shtyrë nga Porta e Lartë dhe se në Kosovë, në Rrafsh të Dukagjinit e gjetkë nuk ka këngë popullore që flasin për krijimin e një shteti autonom shqiptar, madje me grykë të pushkës.

*) Fuqitë e Mëdha.

1) «Këngë trimërie», botim i MMP, Tiranë 1968, f. 74.

Mendimet e tyre tendencioze e subjektive i hedhin poshtë jo vetëm këngët popullore autentike, po edhe vetë burimet arkivale historike, që flasin për ato ngjarje. Lidhur me këtë mjafton të përmendim vetëm diçka nga pohimet e kryekonsullit austriak Lipih, i cili i raportonte ministrit të Jashtëm në Vjenë se:

«Në rrrethana të tilla nuk do të ishte çudi që zjarrri i kryengritjes së atyre viseve të përhapë flakën e tij në të gjitha drejtimet dhe nga efektet shkatërrimitare të tij, kryengritja të kthehet edhe kundër Portës së Lartë. Kryengritësit dhe Lidhja e zotërojnë sot gjendjen politikisht».¹⁾

Sic shihet, lëvizjet dhe kryengritjet e stuhishme masive të popullit shqiptar për vetëmbrojtjen e tërësisë tokësore nga synimet grabitqare imperialiste e shoviniste dhe lufta e vendosur politike e ushtarake për autonomi, ishin shkrirë në një të veime. Masat popullore kryengritëse, të udhëhequra nga Lidhja, nuk kishin asnjë iluzion për sa i përket qëndrimit antishqiptar që ndiqte Porta e Lartë ndaj interesave të popullit shqiptar. Ideja për krijimin e shtetit shqiptar autonom ishte bërë kërkesë themelore e ditës për masat e gjera popullore, të cilat përfaqësohen nga krahu i shëndoshë autonomist. Mirëpo feudalët e bejlerët turkomanë, të cilët ishin bërrë mbështetje shoqërore e politike e Perandorisë Osmane, nuk mund të shkonin krahas me lëvizjen e shtresave të gjera popullore²⁾, madje as të pajtohe-

1) Pëllumb Karkanaqe, «Jemi të gjithë ushtarë», gazeta «Drita» nr. 15, dt. 9 prill 1978.

2) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 151.

shin me të, sepse te lëvizja autonomiste ata shihnin rrezikun vdekjeprurës të interesave të tyre feudale, humbjen e privilegjeve të mëdha që gjëzonin nga Perandoria Osmane.

Në këto rrrethana historike Sulejman Vokshi e Ahmet Koronica nga Gjakova, Ali Ibra nga Malësia e Gjakovës dhe Shuaip Shpahiu e Ymer Prizreni nga Prizreni, më 21 mars 1880 krijuan në Gjakovë *Lidhjen e Re*, e cila pa mëdyshje ishte për krijimin e shtetit shqiptar autonom. Lidhja e Re ishte kundër pushtimit osman, kundër feudalëve dhe çifligarëve të rinj turkomanë dhe kundër çdo dasie krahinore e fetare.

Rryma autonomiste, duke mbrojtur me konsekuençë viset shqiptare nga lakmitë e shteteve shqipistike fqinje dhe duke luftuar kundër politikës imperialiste antishqiptare, që po ndiqnin Fuqitë e Mëdha evropiane, ishte e vendosur të luftonte me po aq vendosmëri edhe kundër çifligarëve turkomanë. Kjo thelloi e forcoi shumë karakterin kombëtar të lëvizjes çlirimtare. Ajo u ngrit mbi ndasitë fetare e krahinore, gjë që u përpoq ta shfrytëzonte me aq dhëlpëri diplomacia evropiane për të vënë në jetë vendimet grabitqare të Kongresit të Berlinit.

*

*

*

Edhe periudha që vjen pas fitores së thellë politike e ushtarake të forcave shqiptare të Lidhjes mbi ato malazeze për mbrojtjen e Plavës e të Gucisë është plot beteja të përgjakshme. Ato, si edhe më

parë, iu imponuan përsëri popullit shqiptar nga lakinët e shovinistëve malazez, nga fuqitë imperialiste dhe nga vetë Porta e Lartë.

Këtë periudhë e karakterizon morali i lartë i popullit shqiptar, rritja e mëtejshme e besimit të masave popullore në forcat e veta të bashkuara, rritja e prestigjit të Lidhjes Shqiptare në arenën ndërkombëtare. Në Lidhje e në degët e saj mbisundonte karakteri kombëtar i lëvizjes kundrejt qëndrimit turkoman të disa pashallarëve, bejlerëve e klerikëve reaksionarë, qëndrimi i prerë autonomist dhe antiosman.

Mbas ngjarjeve të Gjakovës (shtator 1878) dhe fitores së betejave për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë (janar 1880) anekënd trojeve shqiptare mbi zotëronte një frymë e lartë mobilizimi, bashkëpunimi ndërkrahinor, pa dallim krahine e besimi fetar. Zgjimi i madh politik, forcimi i unitetit kombëtar, organizimi dhe vendosmëria e masave popullore për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut nga lakinët shoviniste e imperialiste dhe kundërshtimi i hapët që po i bënte Lidhja Shqiptare Portës së Lartë, tërbuan të gjithë koalicionin e armiqve.

Për të përçarë unitetin kombëtar, për të thyer qëndresën e armatosur të popullit shqiptar dhe për të mposhtur prestigjin e madh të Lidhjes, e cila po mbronte me konsekuençë aspiratat e larta kombëtare, çka shprehej jo vetëm në qëllimet dhe idetë që shtronë, por edhe në mobilizimin e përgjithshëm të të gjitha forcave mendore e fizike kombëtare, i vunë në lëvizje të ethshme shovinistët fqinj, Fuqitë e Mëdha evropiane dhe Portën e Lartë. Koalicioni i armiqve vuri në veprim të gjithë arsenalin e vet politik e ushtarak: presionin, shantazhin, kërcëni-

min, korruksiioni dhe forcën brutale të armëve, kundër një populli të vogël, që guxonë të mos përfillte diktatin e tyre.

Për të vënë në jetë vendimet e turpshme të Kongresit të Berlimit, Rusia sllavomadhe dhe Fuqitë e Mëdha imperialiste vendosën që në vend të Plavës dhe të Gucisë t'i jepnin Malit të Zi krahinat e Hotit, Grudës e Kelmendit. Diplomacia e Fuqive të Mëdha edhe këtë radhë u gabua rëndë, sepse përmbrojtjen e këtyre krahinave shqiptare, siç tregojnë dokumentet historike edhe këngët popullore, u ngritën në këmbë pa dallim krahine e feje, që nga Shkodra, Malësia e Madhe, Rrafshi i Dukagjinit, Kosova, Mirdita, Puka, Luma, Dibra, Elbasani, Gjirokastra e deri në Çamëri. Kështu, me mijëra forca vullnetare të Lidhjes rrokën armët, vrapiuan dhe u ngulën në kufi.

Poeti anonim me mprehtësi politike zbulon edhe një herë dhe demaskon qëndrimin antishqiptar të sultani Hamitit, që po bënte tregti me tokat shqiptare. Me një ironi therëse ai na tregon se:

*Hot e Grudë iu ka dalë fjala,
ia ka falë mreti Nikollës(!)¹)*

Përfaqësuesi i Stambollit, valiu i Shkodrës, më 22 prill të vitit 1880, urdhëroi tërheqjen e forcave turke dhe njëkohësisht lajmëroi shovinistët malazez që t'i pushtonin këto krahina shqiptare. Mirëpo forcat popullore të Lidhjes, që ishin betuar «pa gjak

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 31.

*malet mos me i lshue», po qëndronin në gatishmëri me armë në dorë. Ato, posa u tërhoqën forcat turke të Haxhi pashës për t'ua dorëzuar shovinistëve malazez trojet tonë: «*Shkodër e male qilluen gati*» dhe «*ja xunë shqaut*) istiqamin*». Kështu, forcat e Lidhjes zunë pozicionet dhe u përleshën me forcat agresive malazeze në Urë të Rržhanicës e gjetkë dhe i thyen ato keqas.*

Pas disfatës ushtarake të forcave malazeze, të 12 mijë forcat e armatosura të Lidhjes, të udhëhequra nga Komiteti i Lidhjes Shqiptare pér Shkodrën, u ngulën në Tuz dhe në bregun e majtë të lumit Cem. Pér t'i furnizuar ato me ushqime, armatime etj., përveç Shkodrës e krahinave përreth, kontribuan edhe krahinat e tjera që nga Shkodra, Kosova, Dibra, Vlora, Gjirokastra, Çamëria etj. Kjo tregoi solidaritetin e madh të të gjitha viseve shqiptare dhe gatishmërinë e patundur të mbarë popullit shqiptar pér të mbrojtur me çdo çim trojet e veta.¹⁾

Kjo gatishmëri luftarake, ky solidaritet i fuqishëm, kjo vendosmëri e pashoqe pér të mbrojtur me gjak çdo skaj të tokave shqiptare dëshmon pér ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në një shkallë të paparë deri atëherë. Duke u ngritur mbi çdo dasi krahinore e fetare, populli shqiptar i tregoi botës mbarë se «*feja e shqyptarit asht shqyptaria*».²⁾

Poeti popullor, duke na treguar pér vendosmërinë e paepur të masave popullore, pér guximin e trimërinë, me të cilat u hodhën e qëndruan burrërisht forcat e Lidhjes edhe në betejat e përgjakshme që u

*) Malit të Zi.

1) Histori e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 159-160.

2) Pashko Vasa, «*Shqipnisë së robnueme*», 1880.

zhvilluan në Urën e Rržhanicës midis forcave shqiptare të armatosura keq dhe të forcave shoviniste malažeze na thotë se:

«*T'tanë po nisen si luana,
tuj ba gaz po shkojnë me dekë*.¹⁾

Duke nxjerrë në pah ndjenjën e lartë të detyrës karshi Atdheut, poeti anonim na tregon se posa «*krisi pushka në Urë t'Rržhanicës, / dolën jashtë disa asllana*».

Ata ishin luftëtarët sypatrembur të Lidhjes, bij të thjeshtë të popullit, të cilët ditën të luftojnë si luanë, të thyejnë agresorët dhe të shkruajnë edhe një faqe tjetër të lavdishme të historisë së Atdheut zëmadh.

Këngët popullore theksojnë edhe jehonën e mëdha që bëri qëndresa burrërore e forcave popullore të Lidhjes për mbrojtjen e krahhinave shqiptare. Ato na thonë se me guximin e trimërinë e rrallë të forcave të armatosura të Lidhjes:

*U çuditë gjithë Evropa,
ç'asqer trima paska Shqipnija!*²⁾

* * *

Lidhja Shqiptare që në themelimin e saj e më pas, nëpërmjet memorandumeve dhe vendimeve u

1) «Për vënd tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 32.

2) Po aty, f. 31.

bëri të qartë Portës së Lartë, Fuqive të Mëdha dhe opinionit botëror se mbarë populli shqiptar kërkonte bashkimin e tij kombëtar në një vilajet të vetëm me kryeqendër në një qytet të Shqipërisë. Populli kërkonte të kishte shkollat shqipe, nëpunësit vendës, organet e veta legjislative e ekzekutive dhe ushtrinë e vet kombëtare.

Për realizimin e këtij programi bazë Lidhja luftoi me konsekuencë gjatë të gjithë periudhës së saj më se trevjeçare.

Në këtë drejtim një pikë kulminante shënoi Kuvendi Kombëtar i Lidhjes Shqiptare, që u mblođh në Gjirokastër në korrik të vitit 1880 nën kryesinë e Abdyl Frashërit. Në kushtet e reja që u krijuan, Kuvendi i Gjirokastrës «shtroi kërkesën e shkëputjes nga Porta», që do të sillte «një kthesë në gjithë jetën ekonomike shoqërore e politike të Athdheut»¹⁾.

Vendimet që mori «Kuvendi i Gjirokastrës» ngritën peshë popullin shqiptar, i cili ishte ngritur me armë në dorë për të fituar të drejtat e tij kombëtare.

Poeti anonim nxjerr në pah se në këtë kuvend historik u përfaqësua i gjithë populli shqiptar. Ai thekson bashkimin luftarak të popullit dhe kontributin e shquar që dha udhëheqësi politik i Lidhjes Shqiptare, Abdyl Frashëri edhe në arenën botërore për të mbrojtur aspiratat më të larta kombëtare të popullit shqiptar.

1) Aleks Buda, «Shqiptarët përballë krizës lindore të viteve 1878-1881, revista «Ylli» nr. 2, 1978.

Kënga thotë:

*Kurvelesh e Gegëri,
ç'u mblodhën në Ergjëri*)
ky Abdyl bej Frashëri
ç'u përpoq, i varfëri
çkriu tri barrë flori.
shtatë herë në Frengji.**)
Ç'u përpoqe, bej, për ne,
me mendje, me hazire.¹⁾*

Mbas mbrojtjes së Hotit e të Grudës, ku agresorët malazez pësuan një disfatë tjetër po aq të turpshme, Atdheut tonë po i turrej përsëri rreziku i agresionit shovinisto-imperialist. Armiqtë s'po hiqnin dorë nga planet e tyre agresive e grabitqare. Tani kërcënohej Ulqini shqiptar, ky port i rëndësishëm në Adriatik.

Porta e Lartë e gjetur përpara presionit të Fugive të Mëdha në gusht të vitit 1880 dërgoi Rriza pashën në Shkodër me 3000 forca për t'i dorëzuar Ulqinin Malit të Zi.

Dega e Lidhjes Shqiptare të Ulqinit hodhi kushtimin anekënd viseve shqiptare. Për të mbrojtur Ulqinin, u nisën me ngut mijëra vullnetarë nga Shkodra, malësitë e Veriut, Kosova, Dibra, Tetova etj. Në fillim të shtatorit më se 6000 forca popullore vullnetare të Lidhjes u grumbulluan pranë Ulqinit.

Këtë radhë fuqitë imperialiste evropiane dhe Porta e Lartë, duke vazhduar me kokëfortësi poli-

*) Gjirokastër,

**) Francë, Paris.

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 33.

tikën e tyre agresive antishqiptare, bashkërenduan veprimet e tyre ushtarake me shovinistët malazez dhe morën pjesë në agresion drejtpërsëdrejti me forca të armatosura detare. Ata dërguan 20 anije luftarake me 7000 këmbësorë detarë. Flota ushtarake detare ndërkombejtare, e pajisur me 138 gryka zjarrri, u vendos në Grykat e Kotorrit.

Për të shtypur qëndresën e forcave të Lidhjes, në mbrojtje te visevë shqiptare dhe për t'i dorëzuar Ulqinin Malit të Zi, Porta e Lartë dërgoi mareshalin më gjakatar, Dervish Pashën, me 21 batalione. Me të arritur në Shkodër mareshali i Stambollit (25 tetor 1880) shpalli shtetrrethimin. Qytetin e Shkodrës e rrithoi me 17 batalione osmane dhe ngriti gjyqin ushtarak.

Mbasi bllokoi Shkodrën, me hordhi të shumta ai sulmoi pas shpine forcat vullnetare të Lidhjes që po mbronin Ulqinin. Përleshje shumë të ashpra u zhvilluan në Grykën e Mazhurës etj. midis forcave të Lidhjes të komanduara nga prijësit popullorë besnikë Mehmet Beci, Mehmet Gjyli, Isuf Sokoli etj. dhe hordhive të shumta turke, të komanduara nga Dervish Pasha.¹⁾

Mbas shumë përleshjesh të përgjakshme (nëntor 1880) Fuqitë e Mëdha dhe Porta e Lartë me forcën e armëve arritën të shtypnin qëndresën heroike të popullit shqiptar dhe ua dorëzuan Ulqinin shovinistëve malazez.

Në këngët popullore për mbrojtjen e Ulqinit kumbon i fuqishëm zëri i kushtimit i lëshuar nga

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 181.

Ulgini i kërcënuar, mobilizimi i forcave të Lidhjes për të shpartalluar me grykën e pushkës agresorët e tërbuar malazez. Për të përballuar agresorët, për të mbojtur me gjak Ulginin shqiptar «*në kamë u çue shqiptaria...»¹).*

Ngrihen në këmbë që nga Ulgini i sulmuar deri në Kosovën e vetarmatosur, bijtë e së cilës, si një ortek vërsulen mbi agresorët; që nga Shkodra e Oso Kukëve, që thotë: «*Nuk niggjojmë!*» deri në Dibër e Tetovë; që nga Malësia e Gjakovës, bijtë e së cilës vërsuleshin mbi armikun atje ku rreziku ishte më i madh e deri në Mirditë, Tiranë, e gjetkë.

Këngët për mbrojten e Ulqinit me një forcë të veçantë demaskojnë pazarllëqet e turpshme që bënte sulltani me tokat shqiptare. Ato na tregojnë se Porta e Lartë, për të shpëtuar Stambollin që e ka «*mu-hasere*», ka dërguar hordhi të shumta për të detyruar me forcën e armëve popullin shqiptar që t'ua dorëzojë shovinistëve malazez qytetin shqiptar.

*Në Stamboll a mbledh murtati,
çajre s'asht pa u lshue Ulgini!²*

Për të gjunjëzuar qëndresën burrërore të popullit shqiptar, sulltan Hamidi bëri masakra në massë. Për këtë qëllim, thotë poeti popullor, në krye të hordhive të shumta të armatosura deri në dhëmbë, sulltani ka çuar në Shqipëri «*Dervish xhelatin*», «*që mbledh miletin me axhele*». Por «*Dervish xhelati*» ndeshi përballë një vendosmërie të partundur:

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 34.

2) Po aty, f. 34.

*I thotë Shkodra: — Nuk nigjojmë!
Të shtatë krajlat me u ba urdi,
pa krisë pushkën nuk e lshojmë!¹)*

Forcat popullore të Lidhjes nuk u frikësuan as nga 21 batalionet gjakatare të «Dervish xhelatit», me të cilat u përleshën shumë ashpër në Grykë të Mazhurës etj., as nga të 7000 forcat e këmbësorisë detare dhe 138 grykat e topave të flotës detare ndërkombëtare, që u dërguan nga Fuqitë e Mëdha imperialiste pér të gjunjëzuar forcat kryengritëse; as nga forcat agresive të shovinistëve malazez, të cilat pas grushteve dërrmuese që hëngrën nga forcat e armatosura të Lidhjes në Plavë e në Guci, në Hot, Grudë e Kelmend, as që kishin guxim të afroheshin në fushën e betejës.

Hordhitë osmane të komanduara nga Dervish pasha, pas betejash shumë të përgjakshme, mbasi shtypën qëndresën e popullit shqiptar me zjarr e me hekur, i dorëzuan Ulqinin Malit të Zi.

Këngët historike theksojnë vendosmërinë, guxmin, qëndresën e patundur të forcave popullore shqiptare, të cilat me trimëri të rrallë u përleshën në fushë të betejës me 30 mijë ushtarë turq, duke mos përfillur kërcenimet e flotës detare ndërkombëtare. Ato na japin njoftime të hollësishme edhe pér jehonën e madhe që bëri në arenën botërore qëndresa heroike e forcave të Lidhjes kundër një koalicioni të fuqishëm agresorësh:

*Shkruen gazetat anëpérana,
vojt xhevapi ndër shahllarë:*

1) Po aty, f. 34.

— *Krisi pushka n'istiqamë,
duel mileti me faqe t'bardhë.*¹⁾

Pa rënë në pesimizëm, poeti anonim vë në pah se populli shqiptar vërtet humbi një betejë, po ai nuk e kishte humbur as luftën, as kurajën, as besimin në forcat e veta të bashkuara.

Në gjithë ato përleshje të pabarabarta, populli shqiptar doli faqebardhë, se ashtu si gjatë gjithë historisë, me grykë të pushkës hodhi poshtë vendimet imperialiste antishqiptare të Kongresit të Berlinit dhe korri fitore politike e ushtarake mbi të gjithë koalicionin e armiqve. Me gjithë masat e rrepta ndaluese që kishte vendosur Porta e Lartë dhe me gjithë dizinformimet që jepnin shtetet shoviniste fqinje, opinionit përparimtar botëror i vajti në vesh qendresa vigane e një populli të vogël, por të pamposhtur. Luftën e drejtë që po bënte populli shqiptar për liri, tërësi tokësore, bashkim kombëtar e pavarësi, opioni përparimtar botëror e vlerësoi dhe e miratoi, kurse agresorët, kusarët, tregtarët e gjakut, grabitësit e lirisë e të pavarësisë së popujve i damkosi me turp.

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 34.

«Ideja e madhe dhe kryesore e rilindasve, lidhur ngushtë me luftën e armatosur për çlirimin e popullit dhe pavarësinë e atdheut, ishte bashkimi i popullit dhe krijimi luftarak i unitetit të tij morale-politik, duke vazhduar kështu traditat tonë të lashta e duke i ngritur ato më lart, në një platformë politike çlirintare. Te bashkimi pa dallim feje dhe krahine ata shihnin bazën e vetme të luftës për çlirimin e Shqipërisë».1)

ENVER HOXHA

1) Enver Hoxha, vepra, vëll. 24, Tiranë, 1977, f. 9-10.

III

«NA S'E LËSHOJMË SHQIPËRINË, NA DUAM AUTONOMINË!»

Gjatë gjithë periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit populli shqiptar luftoi pareshtur njëkohësisht kundër synimeve imperialiste dhe lalmive shoviniste, ashtu edhe për bashkimin kombëtar në një shtet autonom shqiptar.

Mirëpo pas shtypjes barbare që i bëri Porta e Lartë qëndresës së popullit shqiptar për mbrojtjen e Ulqinit, kontradikta antagoniste midis Lidhjes dhe Postës së Lartë arriti kulmin.

Lidhja e Re me në krye Abdyl Frashërin, Sulejman Vokshin, Ymer Prizrenin, e patriotë të tjerë, kaloi në veprim. Ajo, duke vënë në jetë vendimin e Kuvendit Kombëtar të Lidhjes Shqiptare, që u mbajt në Gjirokastër, në dhjetor të vitit 1880, u shndërrua në Qeveri të Përkohshme kombëtare dhe me forcat e saj të armatosura filloi dëbimin e qeveritarëve osmanë, duke vendosur pushtetin e Lidhjes me grykë të pushkës.

Porta e Lartë, e alarmuar nga zhvillimi i ngjar-

jeve në Shqipëri, mori masa të ngutshme për të shtypur Lidhjen Shqiptare me zjarr e me hekur.

* *

Në betejat e përgjakshme që kishte zhvilluar populli shqiptar për mbrojtjen e trojeve të veta, Lidhja Shqiptare kishte korrur fitore të thella politike e ushtarake mbi koalicionin armik. Këto fitore të bujshme shërbyen si hallka të një zinxhiri të vetëm për bashkimin kombëtar e për forcimin e mëtejshëm të unititetit kombëtar të popullit shqiptar, i cili ishte përlleshur me armiqtë e tij për tre vjet rresht dhe tani kishte rrokur armët për të realizuar me luftë të armatosur kërkosat e tij autonomiste.

Etja e madhe për liri e pavarësi kombëtare dhe urrejtja e grumbulluar prej shekujsh në gjirin e popullit tonë të robëruar kundër zgjedhës së rëndë osmane, tani ngriten në këmbë mbarë popullin shqiptar. Përpjesëtime më të gjera lëvizja e armatosur antiosmane mori në krahinën e Kosovës dhe në atë të Dibrës.

Formimi i Qeverisë së Përkohshme. Kombëtare të Lidhjes Shqiptare në Prizren shënon pikën kulminante të të gjithë veprimtarisë politike e ushtarake që zhvilloi Lidhja Shqiptare në arenën kombëtare e ndërkombëtare.

Organizimi i reparteve të rregullta të ushtrisë popullore vullnetare kombëtare; çlirimi i Prizrenit, Gjakovës, Pejës, Prishtinës, Mitrovicës, Vuçiternit, Gjilanit e Shkupit nga forcat ushtarake popullore dhe vendosja e pushtetit të Lidhjes; shtrirja e autoritetit

të Lidhjes në Kumanovë, Tetovë, Dibër, Gostivar etj. dhe solidariteti i krahinave të tjera të Shqipërisë së Veriut, të Mesme dhe të Jugut me Qeverinë e Përkohshme të Prizrenit; kërkesat e vendosura autonome drejtuar Portës së Lartë dhe memorandumet që u kishte dërguar Lidhja Shqiptare Fuqive të Mëdha për përkrahjen e tyre, të gjitha këto kishin egër-suar pa masë Portën e Lartë ndaj Lidhjes Shqiptare, e cila tanë kishte kaluar në realizimin e autonomisë me grykë të pushkës. Shtetet ballkanike dhe Fuqitë e Mëdha evropiane po ndiqnin hap pas hapi zhvillimin e ngjarjeve politike e ushtarake në Shqipëri e veçanërisht në Vilajetin e Kosovës. Ato, të shqetësuara për së tepërm nga përparimi i rrufeshëm që po bënин forcat e Lidhjes Shqiptare, ku autoriteti shtetëror i Qeverisë së Përkohshme po shtrihej me shpejtësi në krahinat e tjera të Shqipërisë, ushtruan presion mbi Portën e Lartë që të shtypte me zjarr e hekur Lidhjen Shqiptare dhe qeverinë e saj të përkohshme.

Prandaj konsulli anglez, Blant, duke ndjekur me interesim të veçantë dhe për së afërmë zhvillimin e ngjarjeve politike e ushtarake në Vilajetin e Kosovës dhe shtrirjen e autoritetit të Lidhjes me aq shpejtësi në krahinat e tjera të Shqipërisë¹), nga Selaniku rjoftonte me ngut qendrën e vet se:

«Lidhja vazhdon të jetë superiore në Vilajetin e Kosovës» (24.XI.1880).

...«Forcat e Lidhjes, të komanduara nga Sulejman Vokshi, e kishin marrë Shkupin më 4 janar 1881

1) Gronvill, raporte të konsullit anglez në Selanik, që flasin për zhvillimin e ngjarjeve të Lidhjes Shqiptare, 1880-1881.

dhe Lidhja pengonte transportimin e materialit luftarak nëpërmjet hekurudhës Shkup-Mitrovicë» (19.I.1881).

...«Këtu pa dyshim Lidhja po fiton fuqi dhe po i zëvendëson autoritetet turke në Vilajetin e Kosovës dhe në sanxhakun e Prizrenit» (19.I.1881).

...«Autoriteti i Lidhjes u shtri edhe në Kumanovë, Tetovë, Gostivar e Dibër. Kështu tashti Lidhja vetë po sundonte pa u penguar prej ndokujt» (22.II.1881).

...«Veprimtarinë e Lidhjes e përkrahin shtresat e ulëta të popullsisë shqiptare...»

Populli shqiptar, i vendosur për të fituar të drejtat e veta kombëtare, kishte rrrokur armët dhe po shtrëngonte radhët e veta, që të shkëpuste përgjithmonë zinxhirët shumëshekullorë të robërisë osmane. Ai kërkonte bashkimin kombëtar në një shtet të vetëm autonom shqiptar, që të merrte frymë lirisht në truallin e vet, ta nxirrte Atdheun e vet nga errësira mesjetare dhe ta çonte atë drejt përparimit.

Ai kërkonte të gjëzonte frytet e djersës së vet në trojet e të parëve, sepse nuk duronte grahamën dhe trokëllimën e thundrës osmane, që i kishte marrë frymën.

Populli shqiptar ishte i vendosur që për jetë të jetëve të mos i nënshtrohej asnjë lloj pushtimi apo diktati të të huajit, po të ishte zot fuqiplotë në trojet e veta. Por thundra gjakatare osmane nuk donte t'i shqitej.

Shqipëria, që kishte derdhur aq gjak dhe kishte bërë sakrifica të pallogaritshme, duke mbrojtur trojet e veta, dinjitetin kombëtar për tre vjet rresht

kundër një koalicioni shumë të fuqishëm agresorësh, tani që sa po kishte nisur të griste perden e zezë të robërisë shumëshekullore, ndodhej në prag të një kasaphane të re të përgjakshme. Frytit të përpjekjeve për një Shqipëri pa pranga robërie po i vërsulej përsëri me tërë forcën e armëve kufoma e gjallë e Bosforit që nuk donte ta lëshonte nga kthethrat e saj gjakatare. Ajo donte ta mbyste Shqipërinë përsëri në lumenj gjaku, duke u hakmarrë egërsisht për disfatat e rënda politike e ushtarake që i kishte shkaktuar populli shqiptar gjatë periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Për të shtypur me zjarr e hekur lëvizjen e fuqishme autonomiste, çdo përpjekje të popullit shqiptar për liri e pavarësi, për të shpërndarë dhe shpartalluar Qeverinë e Përkohshme të Lidhjes dhe për të rivendosur përsëri në Shqipëri prestigjin e Portës së Lartë, të përbaltur botërisht, u ngarkua një nga pashallarët më gjakatarë të Perandorisë Osmane, mareshali Dervish pasha.

Dervish pasha në krye të hordhive të shumta ushtarake të armatosura gjer në dhëmbë, më 7 prill të vitit 1881, ia kopsiti në portat e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, ku repartet e tij pararojë, mbasi kishin shtënë më dorë këtë nyje të fortë strategjike, më befasi arrestuan edhe Komitetin e Lidhjes Shqiptare të Shkupit¹).

Në këto çaste shumë kritike për kombin, Qeveria e Përkohshme e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit hodhi kushtrimin anembanë Atdheut.

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 188.

Që nga Prizreni buçiti kushtrimi për mobilizimin të përgjithshëm. Kushtrimi kalon prej fushës së Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit dhe përplaset i fuqishëm e mobilizues në zemër të Alpeve të larta dhe që nga Shkëlzeni në Peshtrik të Hasit, në Gjallicë të Lumës, në Korab të Dibrës e gjetkë nga ku bijtë e tyre armëngjeshur vërsulen si orteget e furishme, që zbresin nga majat e Bjeshkëve të Përhimë dhe turren ku rreziku ishte më i madh, atje ku çdo pëllëmbë tokë duhej të mbrohej me gjak e sakrifica të panumërtë.

Krah për krah me luftëtarët e Rrafshit të Dukagjinit edhe luftëtarët e Malësisë së Gjakovës, të cilëve armiku kurrë nuk ua pa kurrizin, edhe këtë radhë duan të gjenden në vijën e parë të zjarrit. Atje ku i thërret zëri i Atdheut.

Forcat popullore të këtyre viseve rrokin armët «në shtat e n'shtatëdhetë» vjeç: zbresin që nga Shari, Bjeshkët e Namuna, Maja e Hekurave, Shkëlzeni, Pashtriku, Gjallica e Korabi e gjetkë, çajnë nëpër grykat e thella, kalojnë lumenjtë e rrëmbyer nëpër qafat e ngushta, vrapijnë nëpër fushat e gjera dhe ja, me shpejtësinë e erës rreth 6000 forca të Lidhjes tanë ndodhen në vijën e parë të frontit, të vendosura për të matur armët e veta me 34 batalionet gjakatare të Dervish pashës, që më 16 prill 1881 u derdhën në Ferizaj.

Kushtrimi buçet. Ushtojnë fushat e malet, luftëtarët e Lidhjes vrapijnë për të zënë shtigjet e grykat nga do të kalonin hordhitë osmane në drejtim të kryeqendrës së Lidhjes Shqiptare, drejt Prizrenit historik.

Forcat ushtarake të Lidhjes zunë pozicione luftimi në Slivovë, në Shtimje dhe në grykë të Cara-

levës. Ato kanë vendosur që të mbrojnë deri në fund Besëlidhjen Shqiptare, Qeverinë e Përkoħshme të Lidhjes.

*
* * *

Për të mbrojtur Qeverinë e Përkoħshme, forcat e armatosura të Lidhjes, të komanduara nga udheheqësi i shquar ushtarak i Lidhjes Shqiptare, Sulejman Vokshi, dhe nga patriotët trima Ali Ibra, Mic Sokoli etj., zhvilluan luftime shumë të ashpra e të pabarabarta kundër hordhive të shumta ushtarake osmane, të komanduara nga maresħali Dervish pasha.

Betejat më të përgjashme u zhvilluan (prill-maj 1881) në Slivovë, në Shtimje, në Grykë të Caralevës, në Qafë të Dules, në Suharekë dhe e vazhduan qëndresën e armatosur në rrethet e Prizrenit, të Gjakovës etj.

Këto përleshje të përgjakshme shënojnë një ndër kulmet e betejave më të ashpra që iu imponuan popullit shqiptar nga shovinistët fqinjë, nga Fuqitë e Mëdha imperialiste dhe nga Porta e Lartë gjatë periudhës së stuhishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (qershori 1878-prill 1881). Këto beteja janë plot situata epike. Ato të kujtojnë madhështinë e betejave më të lavdishme që zhvilloi populli shqiptar, që nga epoka heroike e Skënderbeut e deri atëherë, në luftërat e tij, të pareshtura për liri e pavarësi, drejtësi shoqërore e përparim.

Në këto beteja heroike forcat e armatosura të Lidhjes, të frysmezuara nga idealet e mëdha për bashkimin kombëtar në shtetin shqiptar autonom, duke

mbrojtur me çdo kusht tërësinë tokësore, nën udhëheqjen e Qeverisë së Përkohshme të Lidhjes Shqiptare, treguan edhe një herë në shkallën më të lartë burrërinë, guximin, trimërinë dhe heroizmin e tyre masiv. Populli shqiptar, duke luftuar për një çështje të drejtë, i shkaktoi armikut humbje të mëdha në njerëz dhe në material luftarak.

Këto beteja të pabarabarta ndezën fantazinë e popullit tonë dhe u bënë objekt frymëzimi për poetët popullorë anonimë.

Në këngët popullore historike të këtij cikli, nëpërmes figurash të fuqishme artistike, me ngjyra të forta realiste, dalin në relief dy botë, dy ushtri: bota e errësirës dhe e shtypjes së egër mesjetare, hordhitë gjakatare të Perandorisë Osmamne që vërshonin për të shtypur me zjarr e hekur popullin shqiptar kryengritës, nga njëra anë, dhe bota shqiptare e popullit kryengritës: Ushtria Popullore vullnetare e Qeverisë së Përkohshme të Lidhjes Shqiptare, që lufton me heroizëm për të qenë i lirë e zot i vërtetë në truallin e gjyshstërgjyshërve.

Aty vihet në pah mizëria e hordhive turke që «*qet pamporri*», qëllimi për të cilin i «*ka que dovleti*» dhe egërsira e tyre për të bërë zap një popull të vogël që kishte guxuar t'i nxirrte gjatë shekujve aq telashe Perandorisë Osmane.

Përballë kësaj bote pushtuesish, shtypësish e shfrytëzuesish barbarë, epika historike vë forcat popullore kryengritëse të Lidhjes, virtytet e tyre të larëta: ndjenjën e thellë të lirisë, dashurinë e madhe për vendin, urrejtjen e pakufishme për pushtuesin, besimin e patundur në forcat e veta, optimizmin e madh dhe vendosmërinë për të vazhduar deri në fund luftën për liri; burrërinë, guximin, trimërinë,

vetmohimin masiv, shpirtin sulmues, me të cilin hidhen luftëtarët e Lidhjes në flakët e pushkëve, në llogoret e armikut, në majat e thikave dhe në grykat e topave të fuqishëm, që vjellin flakë e zjarr pa pushim.

Mizérinë e hordhive turke, që po sillte Dervish pasha në stacionin e Shkupit e të Ferizajt, misionin me të cilin e kishte ngarkuar Porta e Lartë, poeti popullor na e paraqet nëpërmes figurash shumë të fuqishme me anën e një krahasimi të dyfishtë:

*Shumë asqer po qet pampori,
qet Dervisha ma zi se korbi!*¹⁾

Në vargjet e tij plot frymëzim poeti anonim zërthen idenë e vet rrëth misionit të Dervish pa shës. Ai na tregon se atë e «*ka çue dovleti*» për të shtypur me zjarr e hekur kryengritjen popullore: Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Qeverinë e Përkohshme dhe ushtrinë e saj vullnetare, të varrosë përgjithmonë kërkessat autonomiste, idetë e Rilindjes Kombëtare, aspiratat kombëtare të popullit shqiptar, ta nënshtrojë atë, duke e detyruar të dorëzojë armët, të paguajë taksat, të japë nizamë e redifë dhe të mos guxojë kurrë të ngrejë krye kundër Peradorisë Osmane.

Poeti na tregon se Dervish pasha informohet që nga Stambolli për Qeverinë e Përkohshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për forcat e saj të armatosura dhe për përqëndrimin e tyre.

Poeti anonim na thotë:

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 36.

Dervish pasha prej Stambolli:
— Ku i ka çadrat Mic Sokoli?
Ku i ka çadrat, ku i ka t'part,
m'ka çue mreti me ja çartë.¹⁾

Po, Dervish pasha pyet për një nga komandantët kryesorë të forcave ushtarake të Lidhjes, për Mic Sokolin, i cili në epikën tonë historike simbolizon qëndresën e përgjithshme popullore ndaj çdo push-tuesi.

Përpjekjet dhe luftën e vendosur të popullit shqiptar për autonomi dhe egërsimin e sulltan Hamidit ndaj popullit kryengritës të udhëhequr nga Lidhja Shqiptare, poeti na e paraqet në vargun e tij konciz: «*don me kanë shah ner vet*». Prandaj «Dervish xhelatin» e «*ka çue dovleti*» për të shtypur me çdo mjet qëndresën e vendosur dhe luftën vigane të popullit shqiptar për liri e pavarësi kombëtare.

Ngritja e ndërgjegjes kombëtare, bashkimi luftarak rrëth Lidhjes Shqiptare, kërkesat e vendosura për autonomi dhe gatishmëria luftarake e popullit kryengritës për të qenë i lirë, na thotë poeti, e kishin tërbuar e tmerruar Portën e Lartë. Prandaj sulltani e urdhëron Dervish pashën që ta shtypë Lidhjen Shqiptare me çdo kusht:

.
Me ja çart m'ka çue dovleti,
don me kanë shah ner veti;
shah ner veti don me kanë,
kurrgja mretit mos me i dhanë.²⁾

1) Po aty, f. 36.

2) Po aty, f. 36.

Në këto vargje poeti anonim me optimizëm të thellë nxjerr në pah se populli kryengritës shqiptar nuk kërkon lëmoshë. Ai lufton me vendosmëri për të drejtat e tij kombëtare, që të jetojë i lirë në trojet e veta; kërkon të gjelqojë lirinë e pavarësinë kombëtare, të përdorë për interesat e veta kombëtare të gjitha burimet njerëzore e materiale, duke mos i dhënë «*mretit*» as taksa, as ushtar, as «*kurrsgja*». Prandaj populli shqiptar është ngritur në këmbë, ka lidhur besë, ka formuar Qeverinë e Përkohshme Kombëtare të Lidhjes së Prizrenit dhe është ngritur me armë në dorë për të mbrojtur deri në fund të drejtat e veta.

Në këngët popullore të këtij cikli me një forcë të veçantë tingëllojnë thirrjet e kushtimit, masat e ngutshme që marrin luftëtarët e Lidhjes për t'i prerë hovin ekspeditës gjakatare të Dervish pashës, që po marshonte në drejtim të Prizrenit, duke çarë rrugën me grykat e topave të fuqishëm.

*Mic Sokoli po pisket,
Ali Ibrës po i thërrret:
— Merr bajraqet hajde shpejt,
na rrethoi askeri mret!*¹⁾

Epika historike na jep një tablo të gjallë të zhvilimit të këtyre betejave plot situata epike. Aty evo- kohen traditat luftarake të krahinave që vrapijnë në vijë të parë të zjarrit dhe me burrëri hidhen në flakë të barutit:

1) Po aty, f. 36.

*Ku po del kjo flakë e verdhë?
Gashi i Gurit si kurdoherë,
si çdo herë rrema-rrema,
Bajram Rama me shtatë zemra...¹⁾*

Poeti anonim na tregon se udhëheqësi ushtarak i Lidhjes Shqiptare, komandanti i forcave të Lidhjes, Sulejman Vokshi, ka hipur në majë të thepit; vrojton vijën e frontit, vendos forcat dhe evokon traditat luftarake të krahinave të Rrafshit të Dukagjinit, bjtë e të cilave kishin zënë pritat në afërsi të Ferizajt, në Slivovë dhe në Grykë të Caralevës për t'u prerë «*n'thika*», «*n'kacatura*», e «*n'jatagana*» me hordhitë gjakatare osmane.

Përpara hedhjes në sulm, Sulejman Vokshi i këshillon luftëtarët që t'i zënë mirë pritat armikut, të qëllojnë me kujdes në shenjë, të mos u vejë asnje plumb bosh dhe në çastin vendimtar të qëndrojnë si shkëmb për të mos e lënë «*pashën me hi!*» në Kosovë, për të marshuar në drejtim të Prizrenit, ku ishte selia e Qeverisë së Lidhjes Shqiptare:

*Sulejmani ka hip n'thep,
Bash si zana po pisket:
— Ju, Kabash, bini, he burra,
qitni n'thika, kacaturra!
Suharekë, trima ozgana,
bini n'pritë, merrni n'nishana!
O Pojan, o djem, çobana,
preni turqit n'jatagana!
Ju hasjanë prej malsie,*

1) Qemal Haxhihasani, vepër e përmendur, f. 281.

*msyni hasmin si u ka hie!
podrimçakë, he inatxhi,
mos ta lamë pashën me hi!*¹⁾

Në vargjet e këtyre këngëve vihet në pah edhe konstrasti i madh në armatime: Dervish pasha gjuen me topa të fuqishëm, kurse luftëtarët popullorë të Lidhjes zjarrit të artilerisë së rëndë armike i përgjigjen dhe i qëndrojnë përballë duke qitur «*n'thika*», «*n'kacatura*», «*n'jatagana*» e «*me shahi*». Kjo e bën shumë më heroike qëndresën burrërore e të guximshme të luftëtarëve popullorë, të cilët, ndonëse shumë inferiore në njerëz dhe në mjete lufte, pa u trembur nga hordhitë e shumta, as nga zjarri i fuqishëm i artilerisë armike, hidhen dallgë-dallgë në flakë të barutit, duke i shkaktuar atij humbje shumë të mëdha.

* * *

Mbas thyerjes të forcave popullore të Lidhjes në afërsi të Ferizajt, në fshatin Slivovë, luftëtarët e Lidhjes Shqiptare, me një trimëri dhe vendosmëri të rrallë, për pesë ditë e net përballojnë sulmin e forcave turke, duke i gozhduar ato përpara kodrave të zhveshura të Shtimes, ku kishin zënë pozicionet forcat e Lidhjes. Kështu, për të thyer qëndresën e vendosur të forcave populllore të Lidhjes në vijën e parë të zjarrit, Dervish pasha, në mëngjesin e 21

1) M. Memia, «Betejat e forcave popullore shqiptare përmbrojtjen e Lidhjes së Prizrenit nga ekspeditat osmane dhe këngët e popullit», revista «Nëntori» nr. 5, Tiranë 1973, f. 150.

prillit të vitit 1881, u detyrua të vërë në veprim jo vetëm repartet kryesore të këmbësorisë, por edhe artilerinë e rëndë fushore dhe, mbas përleshjes trup me trup dhe humbjeve të rënda nga të dy anët, të ndodhura përparrë rrebeshit të artilerisë armike, forcat popullore tërheqjen në mënyrë të organizuar dhe zënë pozicionet më të përshtatshme në Grykën e Caralevës.¹⁾

Kur flasim për betejat heroike të Slivovës, të Shtimjes, të Grykës së Caralevës etj., na dalin para-sysh virtytet më të larta të popullit tonë, të cilat i karakterizojnë luftëtarët popullorë të Lidhjes: dashuria e pakufishme për vendin, vendosmëria e patundur dhe gatishmëria për të mbrojtur atë me çdo sakrificë; urrejtja e thellë për pushtuesin; etja e pa-shuar për liri e pavarësi, drejtësi shoqërore e përparrim, motive këto që, në castet më vendimtare, i shtyjnë ata të hidhen në llogoret e armikut, në flakët e pushkëve, në majat e thikave, në grykat e topave, duke treguar burrerinë, guximin, trimërinë, tradita këto që kanë kaluar dhe janë zhvilluar nga një brez në tjetrin dhe që tanë ishin të mbrujtura me idetë politike të Lidhjes shqiptare për bashkimin kombëtar në një shtet të vetëm autonom shqiptar.

Burimet historike dhe këngët popullore na thonë se Sulejman Vokshi gjithnjë u gjet në ballë të frontit, në vijën e parë të zjarrit. Shembullin e tij parojë e ndoqën edhe komandantët e forcave popullore të krahinave si Ali Ibra, Mic Sokoli etj. etj.

«—*Bini, djem, t'desim me nerë!*» — thërret Sulejman Vokshi, me kryet e bardhë si mal me borë.

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 190.

«— Do desim të tanë pér mymleqet!», — thërret Ali Ibra, që «po i shkon gjaku pér zinxhi».

«—Përpara, shokë, se toka jonë asht e shtrenjtë!», — thërret Mic Sokoli me «shtat martina», «n'shtat». Dhe si shqipe mali këta luftëtarë të paepur të Rilindjes sonë Kombëtare, këta kapedanë të shquar të luftërave popullore, prijnë në ballë të sulmit të furishëm.

Udhëheqësi ushtarak i Lidhjes Shqiptare, Sulejman Vokshi, na thotë poeti, kërkonte ta shtinte në shënjestër kryekomandantin e hordhive osmane. Po ku ta gjente «Dervish Xhelatin», që nuk i afrohej vijës së zjarrit:

— Zo Dervishi ku a vet?
pesë zabit ja lash pa jetë,
du' n'Dervishin me u zatetë...
t'ja qes zemrën në ledinë,
orlat gjakun le t'ja pinë,
se dy herë na pruni sherr,
bini, djem, t'desim me nerë!!!¹⁾

Sulme të egra të armikut, kundërsulme të furishme të luftëtarëve të Lidhjes. Luftëtarët populloër me martina, shahi, jatagana e thika në dorë hidhen si shqiponjat mbi korbat e Dervish pashës dhe kacafyten trup me trup:

Ali Ibra po pisket,
n'thikë pi' rrxon ka shtat' a tetë...²⁾

*) pér popullin, pér Atdheun.

1) M. Memia, artikull i përmendur, f. 151.

2) Po aty, f. 151.

Beteja, na thonë këngët, vazhdon aq e furishme, sa kryengritësit kalojnë përmbi kufomat e panumërtë të hordhive osmane, ku gjaku kishte arritur deri në bark të kalit:

*Ali Ibra me gashnjanë,
përmbi turq po ban denam...¹⁾
Bajram Rama i Malësisë,
fort ja dha dorën shahisë;
ja dha dorën e ja dha gishtin:
— A m'i patë Zmajlin e Micin ?
— Fejt ëm fejt,* tha, me Dervishin!²⁾*

Caralevë! Sulmeve të egra të hordhive osmane forcat e Lidhjes u përgjigjen me kundërsulme të furishme. Pesë orë përleshje trup me trup.³⁾ Edhe në situata më të rënda, poeti popullor na jep moralin e lartë të luftëtarëve të Lidhjes, optimizmin e tyre të thellë:

*Ali Ibra n'vraç të zi,
po i shkon gjaku për zinxhi.⁴⁾
Qëndroni burra, bani gjaret,
s'do ta lamë asqerin mret!⁵⁾*

Shembulli pararojë i udhëheqësit ushtarak të Lidhjes, Sulejman Vokshi, që «pesë zabit» i la «pa

1) Po aty, f. 151.

*) fyt më fyt.

2) Për vend tonë jam tuj luftue, Tiranë 1968, f. 36.

3) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 190.

4) M. Memia, artikull i përmendur, f. 151.

5) Qemal Haxhihasani, vepër e përmendur, f. 281.

jetë» dhe kérkon të gjejë Dervish pashën «*t'ia qes zemrën në ledinë»;* dhe i prijesve të tjerë popullorë, si Mic Sokoli, që pérleshet «*fejt ëm fejt me Dervishin»;* Ali Ibra, që «*n'thikë p'i rrxon ka shtat' a tetë» dhe «*po i shko' gjaku për zinxhi»;* frymëzon forcat popullore të Lidhjes, ngre shumë lart moralin e tyre, optimizmin e thellë, shpirtin luftarak e sulmues, gatishmérinë për t'u fliuar prapë e prapë për lirinë e Atdheut:*

Mic Sokoli ban me dorë:

— *Bini, shokë, se s'muj me folë,*
se m'ka ra do gjak në gojë,
se m'ka ra do gjak në bark,
*Shtat martina i kam n'shtat.*¹⁾

Për të thyer qëndresën e luftëtarëve të Lidhjes Dervish pasha hedh në sulm forcat më të freskëta dhe armatimet më të fuqishme. Sulmet e egra të hor-dhive osmane zmbrapsen për orë të tëra nga kundërsulmet e furishme të forcave të Lidhjes. Pérleshjet zhvillohen trup me trup. Toka mbulohet me kufoma nga të dy palët.

Mis Sokoli, një ndër komandantët e shquar të këtyre betejave, në këto çaste tepër kritike, kur në fushën e betejës kanë rënë me qindra trima sypatrembur, për t'u dhënë zemër bashkëluftëtarëve të tij, me «*shtatë martina»* në «*shtat»* kur topat e fuqishëm të armikut po villnin flakë e zjarr pa pushim mbi forcat e Lidhjes, me trupin e tij ai si një shkëmb mylli grykën e topit armik:

1) M. Memia, artikull i përmendur, f. 152.

*Mic Sokolin e vau reja,
e vau reja, e vau moti,
e vau Dervishi me gjyle topi.¹⁾*

Kështu, poeti popullor na jep figurën e këtij luftëtarit të madh popullor, figurë kjo që shkëlqen në historinë e luftërave vigane të popullit tonë si një yll i rrallë i burrërisë, guximit, trimërisë dhe i heroizmit popullor.

Heroizmi i këtij kreshniku të maleve tona, i këtij luftëtarit të paepur të Lidhjes Shqiptare, frymëzon për akte të reja heroizmi shokët e tij, qindra e mijëra bashkëluftëtarë të Lidhjes, të cilët janë të vendosur të luftojnë derisa t'i shkëputin prangat e robërisë, të thyejnë copë e grimë zgjedhën e rëndë osmane dhe t'i japid popullit lirinë e pavarësinë.

Thirrje kushtimi lëshon udhëheqësi ushtarak dhe kryekomandanti i forcave të Lidhjes, Sulejman Vokshi, duke evokuar traditat patriotike luftarake të shqiptarit:

*— Bini, djem, t'desim me nerë!
se shqiptari dy gzime ka
nja kur le dhe n'luftë me ra.²⁾*

Poeti anonim, duke vënë thirrjen e kushtimit në gojën e këtij luftëtarit të madh të Lidhjes Shqiptare, theksion tiparin më karakteristik të popullit shqiptar, për të cilin gjatë gjithë historisë nderi më i

1) Për vend tonë jem tuj luftue, Tiranë 1968, f. 36.

2) M. Memia, artikull i përmendur, f. 153.

madh ka qenë flijimi për lirinë e pavarësinë e At-dheut. Prandaj trimat e rënë në fushën e nderit ai kurrë nuk i ka vajtuar, por i ka përjetësuar në epikën historike, duke e bërë veprën e tyre burim të fuqishëm frymëzimi për breza të tërë luftëtarësh popullorë.

Me krenari të ligjshme rapsodi popullor na tregon se shqiptari gjatë gjithë historisë së tij, në luftërat e tij të drejta çlirimtare, vdes «*me ner*» dhe këtë vdekje e ka gëzim, e ka festë njëloj si edhe lindjen.

Forcat e Lidhjes, ndonëse u janë mbaruar fishekët dhe ndodhen përballë sulmeve të ashpra të mizërisë së hordhive osmane, nuk tërhiqen. Ato qëndrojnë trimërisht dhe kacafyten dhëmb për dhëmb nëpër ato fusha, kodra, lugje, gryka e qafa, duke i gozhduar në vend forcat turke.

Kënga na thotë:

*Men martina, shpraz koburja,
kjo koburja s'po kërcet,
Ali Ibra po pisket:
— Nuk dom' krajl as nuk dom' mret,
po desim për mymleqet!*¹⁾

Poeti popullor tërthorazi na tregon se dhe pse kryengritësve u janë mbaruar fishekët e armëve të gjata, ata po luftojnë me armë të shkurtra, krismat e të cilave nuk dëgjohen nga gjëmimi i artilerisë së fuqishmme të armikut. Ai në vargjet e tij, të vëna në

1) M. Memia, artikull i përmendur, f. 153.

gojën e njërit ndër komandantët e shquar të forcave ushtarake të Lidhjes, trimit të paepur Ali Ibra, që gjithmonë prin në ballë të sulmit, nxjerr përsëri në pah vendosmërinë e patundur të luftëtarëve kryengritës për të mos i lëshuar amrët, por për të vazduar luftën pa ndërprerje kundër pushtuesve osmanë dhe shovinistëve fqinjë.

Vargut të pambarim të dëshmorëve të kombit iu shtuan edhe 800 të rënë të tjerë në këto beteja heroike, të cilët e shpaguan veten në fushë të betejën me më se 1800¹⁾ pushtues osmanlinj.

Këngët popullore që flasin për këto beteja, krahas udhëheqësve dhe komandantëve të shquar të forcave ushtarake të Lidhjes, theksojnë dhe bëmat e heroizmin e luftëtarëve të thjeshtë, si Zmajl Hyseni, që «ish kanë drague» dhe «në fushë t'Shtimjes sot» është «nal»; Zmajl Mehmeti, që së bashku me Mic Sokolin u përleshën «fyt e n'fyt» me Dervish pashën, Ali Neza, që u hodh në sulm si «zog sokoli» dhe «met shehit te llogori»; Bajram Rama «me shtat zemra», që pasi pyet për Zmajlin e Micin, «fort ja dha dorën shahisë» dhe u hodh në sulm si rrufeja, etj. etj. Kështu, këngët popullore, në pamundësi për të përmendur me emër të 800 trimat që ranë në fushën e ndërit, duke nxjerrë në relief bëmat e Mic Sokolit, Zmajl Hysenit, Bajram Ramës, Zmajl Mehmetit, Ali Nezës etj., flijimi i të cilëve simbolizon heroizmin kolektiv të forcave ushtarake të Lidhjes, vendosmërinë e popullit shqiptar, në pak vargje të skalitura si në mermer na jep portretin e plotë të të gjithë trimave që u flijuan në luftën për liri e pavarësi kombetare.

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 190.

Kënga popullore na jep edhe portretin moral të udhëheqësve dhe të komandantëve më të shquar të forcave ushtarake të Lidhjes: Sulejman Vokshit, Ali Ibrës e Mic Sokolit. Këngëtari popullor nxjerr në pah jo vetëm aftësinë e tyre drejtujese e komanduese, por edhe shembullin pararojë. Ata prijnë gjithnjë në ballë të sulmit. Kështu, këto figura të gdhendura me aq mjeshtëri, në përfytyrimin tonë mbeten të paepura, sa të thjeshta, aq madhështore, legjendare, simbol i udhëheqësve popullorë, trima, të guximshëm e besnikë.

Betejat, na thotë kënga, janë zhvilluar aq të ashpra, saqë nga tymi e flaka, «*në fushë të Kosovës a lidh jezeri*», është bërë mjegull.

Trimat e rënë sipas traditës në çastin e fundit u lënë amanet prindërve, bashkëluftëtarëve dhe brezave pasardhës që t'ua marrin hakun, sepse ata «*në fushë të Shtimjes sot*» janë «*nalë*» për të mos i lënë hordhitë osmane të shtypin qeverinë e Lidhjes Shqiptare.

Poeti popullor vë në pah se djalëria shqiptare në lulen e rinisë, për të përballuar rrezikun e madh që i kërcënohej Atdheut, duke ndjekur traditat e të parëve, kanë lënë «*krushqit thirrë*», e «*vaden*» me i «*shkue*» dhe vrapan si era atje ku i thërriste zëri i fuqishëm i Atdheut. Ata u vërsulën atje ku rreziku ishte më i madh dhe në betejat e përgjakshme dhjetëra prej tyre u «*ndalën*» në fushë të betejës në Slivovë, «*në fushë të Shtimjes*», në Grykë të Căralevës, në Qafë të Dules, në Suharekë, apo në rrethet e Prizrenit e të Gjakovës për t'u prerë hovin «*Dervishave ma zi se korbi*» dhe mbas betejave të përgjakshme «*kurrkush vorrin s'ja ka gjetë!*»

*Hysen Zmajli i hypi atit,
ja dha malit, ja dha shpatit,
me kërkue vorrin e djalit.¹⁾*

Kënga popullore, duke folur për Hysen Zmajlin, tërthorazi na tregon se luftëtarët që ranë në këto beteja të pabarabarta dhe shumë të përgjakshme, kishin vajtur edhe nga krahina të largëta të Atdheut, por Hysen Zmajlit, që tani është plakur, nuk i bën këmbla e dora të shkojë në fushë të Kosovës si dikur që nga Malësia e Gjakovës. Prandaj ai i hipën atit, kalon lumenj, pllaja e kodra, lugina e qafa, shpate e gërxhe, male e fusha dhe shkon në vendin e betejave të mëdha për të parë varrin e djalit.

Në vargjet mallëngjyese, por pa asnje notë pesimizmi e fatalizmi, të vëna në gojën e të atit të njërit ndër heronjtë e këtyre betejave, kënga vë në pah lumenjtë e gjakut që kanë derdhur bijtë e Shqipërisë për të fituar lirin e pavarësinë, duke mos kursyer jetën e tyre:

— *Kam dashtë djalin me e martue,
krushqit thirrë, vadja m'ka shkue!
Zmajl Hyseni hupë e tretë,
kurrkush vorrin s'ja ka gjetë²⁾*

Dervish pasha vetëm pasi e shtroi rrugën nga Ferizaj deri në Prizren e Gjakovë me 1800 kufoma hordhish osmane, në saje të forcave të shumta dhe zjarrit të fuqishëm të artilerisë së rëndë fushore dhe të qëndrimit tradhtar të pashallarëve e të bejlerëve

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 39.
2) Po aty, f. 39.

turkomanë shqiptarë, duke kaluar mbi tokën e përgjakur nga qindra e qindra luftëtarë të lirisë, arriti të çajë rrugën dhe të marshojë në drejtim të Prizrenit historik me qëllim që të shpartallojë nga themeli Besëlidhjen Shqiptare.

Kënga na thotë:

*Kudo vu njaj turku kamë,
gjak e vorre e ka bamë...¹⁾*

Kryengritjet dhe qëndresën titanike të popullit shqiptar, barbarizmat e hordhive osmane për të shtypur me zjarr e hekur Besëlidhjen Shqiptare, batërdinë e madhe që u bë, heroizmin e trimave, poeti anonim na e jep me ngjyra shumë të forta, dhe me një notë të theksuar optimizmi. Ai thekson se këto beteja heroike nuk qenë një luftë lokale për interesat e ngushta të krahinës ose për disa kërkesa të pjesshme, por këtu trimat e Shqipërisë luftuan përlirinë e pavarësinë e Atdheut. Poeti thekson se përluftëtarët e Lidhjes shqiptare liria e Atdheut, mbrojtja e tërësisë tokësore, bashkimi kombëtar ishin më të shtrenjta sejeta e tyre në pranverën e djalërisë, të pjekurisë burrërore apo të pleqërisë thinjoshe, por të shkrumbuar përliri e pavarësi kombëtare, përdrejtësi e përparim shoqëror:

*Na janë vra e na janë pre,
kanë dhanë jetën si me le,
tue luftue trimat për atdhe.²⁾*

1) M. Memia, artikull i përmendur, f. 155.

2) Po aty, f. 155.

Në këto çaste shumë të vështira, kur anembanë Kosovës «Dervish Xhelati» «*gjak e varre*» e ka bërë, poeti, duke shprehur ndjenjat e thella të popullit kryengritës, shpirtin e tij titanik, ngre lart qëndrimin heroik të njerit prej prijësve popullorë, Sefë Koshares, të cilin Dervish pasha e vari në fushë të betejës.

Duke i kënduar fundit heroik të Sefë Koshares, këtij trimi të paepur, poeti vë në pah ndërgjegjen e lartë kombëtare, vetëdijen politike të popullit shqiptar, të luftëtarëve të Lidhjes, që s'dinë nder më të madh sesa të bien për Atdhe:

— *Sefë Kosharja, i pari i fisit,
hije t'paska majë e lisit!*
— *Hije m'ka, o djemt' e mi,
kam dhanë jetën për Shqipni!*¹⁾

Në përgjigjen e tij krenare që e kreu me nder detyrën e lartë ndaj Atdheut tingëllon me një forcë të jashtëzakonshme ndjenja e thellë e detyrës ndaj Atdheut të robëruar, të mbytur në gjak, të mbushur me trekëmbësha, me varre e plagë të pashëruara. Në këto vargje heroike buçet zëri i fuqishëm i kushtimit për t'u ngritur përsëri e përsëri në këmbë anembanë Atdheut mbarë populli shqiptar: djalëria, burrat, gratë, pleqtë dhe si një vullkan i papërmbaritur të «*zhibijnë*» pushtuesit otomanë nga toka shqiptare.

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 40.

* * *

Populli kryengritës, me mprehtësinë e tij politike, ka ndjekur hap pas hapi zhvillimin e ngjarjeve, të brendshme e të jashtme, qëndrimin e lëkundshëm e tradhtar të atyre pashallarëve, bejlerëve e klerikëve turkomanë, të cilët, në çastet më kritike, kur kombit shqiptar po i turrej rreziku më i madh, sabotuan përhapjen e kushtimit të dhënë nga Qeveria e Përkoħshme e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe, pér të forcuar pozitat e tyre feudale, duke shkelur Besëlidhjen Shqiptare, iu dorëzuan Dervish pashës me të arritur ai në Ferizaj.¹⁾

Qëndrimi i tyre antikombëtar la jehonën e vet në folklorin tonë popullor të asaj periudhe. Poeti, duke vënë vargjet e tij në gojën e një luftëtari të Lidhjes, shpreh zemërimin e thellë të kryengritësve, të mbarë popullit shqiptar, pér minimin që i bëri Dervish pasha Besëlidhjes Shqiptare me anën e korrupimit të kërreve turkomanë shqiptarë:

— Hajmedet pér mymleqet!*)
ky murtati i babdovletit,**)
ç'po ja prish besën miletit...²⁾

Punën minuese pér mospërhapjen me kohë të kushtimit në të gjitha krahinat, e sidomos në Fu-

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 189.

*) pér popullin shqiptar.

**) i ngarkuari i sulltanit, Dervish pasha.

2) M. Memia, artikull i përmendur, f. 157.

shën e Kosovës, e gjetkë, na e tregojnë disa fragmente këngësh, ku flitet për arritjen me vonesë, ose pasi kishin përfunduar betejat e Shtimjes e të Caralevës, të luftëtarëve të qindra fshatrave të Kosovës, si p.sh. Ostrozubit, Drenicës etj.:

*Ostrozubi bajrak n'atë bri,
n'Qafë të Dules vonë kanë mrri. . .¹⁾*

Ose për drenicakët që nuk ishin lajmëruar fare, por ushtima e topave të ekspeditës osmane i ngriti në këmbë dhe vetëm atëherë drenicakët trima vërhojnë si orteqet, por është tepër vonë:

*Drenicë e kuqe u çue n'kam,
ryrash, djem, t'biem n'lypjan!
Asht vatani në zaman,^{*)}
'i pash' i zi po ban danam.
Drenicakë trima drague,
zerzele maleve janë lshue. . .²⁾*

Vetëm mbas tetë ditë e net betejash trup me trup në Slivovë, në Shtimje, në Caralevë, në Qafë të Dules e në Suharekë, eksperita ushtarake osmane e Dervish pashës, duke shtypur me zjarr e hekur qëndressën heroike të forcave ushtarake të Lidhjes, më 28 prill të vitit 1881 mundi të ripushtonte Prizrenin.

Me gjithë pushtimin e Prizrenit dhe gjendjen e jashtëzakonshme që u krijua anembanë Kosovës, me gjithë masakrat, arrestmiet, ekzekutimet, varjet në

1) Po aty, f. 157.

*) në rrezik.

2) M. Memia, artikull i përmendur, f. 157.

litar, burgosjet, internimet në masë, Gjakova e Suljejman Vokshit, këtij luftëtarë të madh kombëtar, nuk i lëshon armët. Ajo qëndron.

Udhëheqësi ushtarak i Lidhjes Shqiptare, Suljejman Vokshi, bashkë me patriotët e shquar Ymer Prizreni, Ali Ibra e të tjerë riorganizon me shpejtësi forcat dhe vazhdon qëndresën e armatosur deri në fund. Forcat e Lidhjes për shumë ditë e net me radhë zembrapsin me dhjetëra sulme të ashpra të hordhive osmane, duke mos i lënë të marshojnë në krahinën e Gjakovës.¹⁾

Për të shtënë në dorë Gjakovën e kuqe, që u bë varr për pashallarët turq, Dervish pashës iu deshën edhe dhjetë batalione të tjera, që i erdhën me ngut nga Tesalia.

Më 8 maj të vitit 1881 Gjakova ripushtohet përsëri nga ekspeditat gjakatare osmane. Forcat ushtarake të Lidhjes, të udhëhequra nga prijësit besnikë e të paepur, tërhiqen në mënyrë të organizuar në Malësi të Gjakovës. Në këto anë s'mundi kurrë të vendoset sundimi osman. Prej andej bile organizoheshin herë pas here dhe shpesh merrnin pikënisjen e tyre kryengritjet e fuqishme popullore kundër pushtuesve osmanë.

Bijtë e denjë të popullit, luftëtarët e Lidhjes Shqiptare, që luftuan me aq heroizëm për tre vjet me radhë për të mbrojtur tërësinë tokësore të At-dheut, për bashkimin kombëtar dhe për krijimin e shtetit shqiptar autonom përsëri shtrëngojnë radhët e veta luftarake dhe zënë pozicione të pathyeshme në veriperëndim të Gjakovës.

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 190.

Dhe me të vërtetë, Dervish pasha, që kishte prouuar në kurriz vramën luftarake të trimave «të çartun», luftëtarëve të Lidhjes, jo vetëm nuk pati guxim të matej përsëri me forcat popullore kryengritëse, që ishin bërë shkëmb i pakapërcyeshëm në Qafë të Morinës,¹⁾ në Qafë të Prushit, në Qafë të Stobedës dhe në Qafë të Gjonit, por, sipas burimeve historike, edhe në Gjakovë e në Pejë qëndronte gjithmonë me frikë se mos e sulmonte populli i Malësisë së Gjakovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit.

Toka shqiptare, Kosova e martirizuar, u përmbyt përsëri në gjakun e bijve të saj më të mirë. Po ajo s'do të kursente gjakun e saj dhe të brezave pashdhës gjersa t'i bënte copë e grimë prangat e robërisë dhe mbi qiellin e trojeve shqiptare të mos mbejtej këmbë pushtuesi.

Në këngët popullore historike të këtyre betejave kudo spikat optimizmi i thellë, besimi në forcat e veta, papërkulshmöria, vendosmöria e shpirtit titanik i popullit kryengritës për të vazhduar luftën deri në fitoren e plotë mbi pushtuesit barbarë.

Me vargjet e tij optimiste poeti anonim, pasi na jep tablonë e përgjakshme të Kosovës, ku nga zjarri i artilerisë armike çdo gjë e ka mbuluar mjegulla dhe nuk duket asnjë rreze dielli, me një besim të patundur në luftën popullore ai na thotë se:

«*Kryengritja nuk asht shue,
ma e fortë lufta ka fillue...»²⁾*

Kështu, poeti popullor, i frysmezuar nga qëndrë-

1) Historia e Shqipërisë II, Tiranë 1965, f. 151.

2) M. Memia, artikull i përmendur, f. 159.

sa e popullit kryengritës, shpreh bindjen e thellë se sa më të egra të jenë masakrat e pushutesit, aq më të fuqishme do të jenë kryengritjet shqiptare antiosmane deri në fitoren e lirisë e të pavarësisë kombëtare, gjë që e vërtetuan kryengritjet e pareshtura gjatë viteve e dekadave të pastajme.

Udhëheqësi ushtarak i Lidhjes Shqiptare, Sulejman Vokshi, Ymer Prizreni, Ali Ibra etj. dolën në Malësi të Gjakovës. Aty u grumbulluan mijëra kryengritës të Rrafshit të Dukagjinit, të Malësisë së Gjakovës dhe të Hasit të Thatë për të vazhduar qëndrësën e armatosur antiosmane.

Për t'i shpëtuar terrorist të egër e masakrave në masë, një pjesë e popullatës së Gjakovës dhe e fshatrave të Rrafshit të Dukagjinit ishin larguar nëpër bjeshkët e larta ku nuk arrinte dora gjakatare e ekspeditës ndëshkimore osmane.

Dervish pashës, që kërkon të shtjerë në dorë me cdo kusht udhëheqësin ushtarak të Lidhjes Shqiptare, Sulejman Vokshin, poeti populor i jep një përgjigje sa therëse, aq dhe krenare:

*C'po pëvet Dervish pasha:
— Zo, ku rrin Sulejman aga?
— N'ato bjeshkë, te retë e bardha...¹⁾*

Kështu, poeti e paralajmëron xhelatin se luftëtarët e Lidhjes qëndrojnë «në ato bjeshkë» te retë e bardha, në kështjellat e tyre natyrore, nga ku herë pas here do të vërshojnë mbi pushtuesit po me atë vrull të pandalshëm, siç vërshojnë orteqet nga bjeshkët tona.

1) Q. Haxhihasani, vepër e përmendur, f. 282.

Dhe kur pashai pyet për popullin kryengritës, ai merr një përgjigje akoma më të qartë e më të prerë, më të vendosur e paralajmëruese për shpërthimin e përleshjeve të reja me Perandorinë Osmane, vargje këto që përshkohen nga një optimizëm i thellë:

Dervish pasha po pëvet:

— *Zo mileti kah u tret?*

— *Q'atje nelt, ku zbardhin retë,
koftë kysmet do' i shohsh opet!*)* ¹⁾

Dhe me të vërtetë, ndonëse Qeveria e Lidhjes Shqiptare u shtyp barbarisht, flakët e kryengritjeve antiosmane nuk u shuan; ato u ngritën njëra pas tjetrës dallgë-dallgë.

Kryengritësit nuk i dorëzuan armët. Ata po qëndronin nëpër male. Porta e Lartë drëgoi forca të shumta të komanduara nga pashallarët më gjakatarë në Kosovë, Dibër, Shkodër, Çermenikë, Shpat të Elbasanit e në krahina të tjera të Shqipërisë për t'i nënshtruar, për t'i çarmatosur, për t'u marrë taksat dhe djemtë ushtarë. Por me gjithë demagogjinë, masakrat e terrorin në masë ajo nuk ia arri qëllimit, sepse populli shqiptar ishte i vendosur të luftonte deri në fund.

Udhëheqësi ushtarak i Lidhjes Shqiptare, Sulejman Vokshi, për asnjë çast nuk e pushoi veprimta-

*) përsëri

1) M. Memia, artikull i përmendur, f. 159.

rinë e tij politike e luftarake antiosmane. Ai së bashku me Ali Ibrën e patriotë të tjerë besnikë më 1885 organizoi një kryengritje tjetër antiosmane në Rrafsh të Dukagjinit dhe në Malësi të Gjakovës kundër hordhive turke të komanduara nga Vesel pasha.

Kënga popullore na thotë:

Sulejmani), burrë dai,**)
po shkrue letrat, i qet n'Malsi,***)
a mblohd Malsia plot katër mi,
Ali Ibra a dalë po u pri,
si asllan n'vraq të zi.¹⁾*

Përlleshje të përgjakshme u zhvilluan më 1883 në afërsi të Kastratit midis malësorëve dhe forcave osmane të komanduara nga Hafiz pasha, i cili u detyrua të largohet me ngut nga fusha e betejës.

Kryengritësit, thekson kënga, e paralajmërojnë këtë pasha:

*Hafiz Pashë, n'daç me i hikë vorrit,
sdrypi atit, hyp vaporrit.
Hafiz Pashë, na ke tradhtue,
por fort shpejt ke me e pague,
pse as mret, as Nkollë****) nuk drue!²⁾*

*) Sulejman Vokshi

**) burrë, trim i paepur, besnik,

***) në Malësi të Gjakovës (tani trethi i Tropojës)

****) as Perandorisë Osmane, as Knjaz Nikollës s'iа kemi frikën.

1) «Për vend tonë jam tuj luftue», Tiranë 1968, f. 47.

2) Po aty, f. 45.

Poeti anonim na tregon se Porta e Lartë ishte egërsuar aq shumë, saqë përpinqej ta kthente Shqipërinë në gërmadhë, por nga qëndresa vigane e kryengritësve shqiptarë, të cilët nuk po i ulnin armët, malet u tundën:

*Dojshin Dibrën me e gjegun,
me e gjegë e me e bo shpuzë
mos këndojoë as xhel, as pulë,*

• • • • •

por ekspeditave osmane, sipas traditës, populli kryengritës iu përgjigj me grykë të pushkës:

*Kour vëkati Jousuf ag Dibra:
— Allahni*), gjem, fishek' e martina!
Kour vëkati Nourçe Leveni,**)
nënd malet***) çoi i shembi!¹)*

Poeti anonim e paralajmëron të dërguarin e Stambollit se populli shqiptar nuk do t'i japë asgjë sulltanit, madje çdo masakre e terrori ai do t'i përgjitanit, gjet me grykëhollën, të cilën s'ka forcë që t'ia heqë nga dora:

*Tan malsia a çue n'kamë,
s'ka të dheta, as nizamë,
do majmë armë, do majmë xhephanë,
Dibëra mbetet si ka kanë.²⁾*

*) bini, djem, e rrrokni armët.

**) Pustina.

***) Nëntë malet e Dibrës.

1) «Këngë popullore historike», Tiranë 1962, f. 34.

2) Po aty, f. 63.

Kështu iu përgjigj populli heroik i Dibrës Hysni pashës më 1885, i cili u detyrua t'ua mbathte këmbëve i turpëruar.

Në qëndresën e armatosur antiosmane, na thonë këngët popullore, krah për krah me burrat morën pjesë edhe vajzat e gratë trimëresha, të cilat u dhanë plumbin ballit si pushtuesve ashtu edhe bashkëpunëtorëve të tyre:

— *Moj Myslime**)*, ime motër,*
*merr shishanen***) *e shtjer m'Çotën!****)¹⁾

Mëngët autentike na tregojnë se, kur shtrohej çështja e luftës kundër pushtuesit, femra shqiptare kurdoherë iu gjet në krah burrave dhe vëllezërve për t'i vënë pushkën cilitdo që merrte nëpër këmbë dinjitetin kombëtar.

Me një forcë të madhe përgjithsuese poeti anonim na ka dhënë femrën sokoleshë, që nuk e njeh frikën, por me armë në dorë, nga e njëjta llogore, lufton me heroizëm të rrallë:

— *O Halit, ku don me shkue?*
— *N'kullë t'Tahirit, m'u ngujue.*
S'kish pasë burrë, ish kanë ni grue,

*) Motra e Xhaferr Kampullës nga Skroska e Librazhdit, i cili së bashku me të motrën u vunë pushkën pushtuesve osmanë e veglave të tij.

**) pushkë

***) pari e Çermenikës, vegël e qeverisë turke

1) «Këngë popullore historike», Tiranë 1962, f. 65.

*si sokol motra m'ka nimue.
— Vlla i motrës, mor Halit!
Motra mbush, Haliti qit.¹⁾*

Ashtu si gjatë gjithë historisë sonë luftarake, gjatë periudhës heroike të Lidhjes, gruaja shqiptare dha një kontribut të pallogaritshëm, duke siguruar një prapavijë të sigurtë në luftërat e pabarabarta trevjeçare që i imponuan popullit shqiptar pushtuesit truq dhe agresorët shovinisto-imperialistë.

Zgjimi i madh politik, ngritja e ndërgjegjes kombëtare deri në atë shkallë saqë luftëtarët e Lidhjes të mbyllin grykat e topave të armikut me gjokset e tyre, ngulitja te masat popullore e ideve të Lidhjes Shqiptare dhe gatishmëria luftarake e popullit kryengritës, e burrave dhe e grave, për t'u shkrirë «*për Shqipni*», për t'i «*zhbi*» pushtuesit osmanë dhe për të mos iu nënshtuar asnjë fuqie të huaj, mbeti një burim i fuqishëm frymëzimi për poetët anonimë dhe krijuesit e të gjitha periudhave. Për këtë na flet dialogu i zjarrtë e optimist që zhvillohet midis nënës shqiptare dhe të birit që po nisej për t'u prerë hovin hordhive gjakatare që kishte dërguar sultani për të imposhtur popullin kryengritës shqiptar.

*Mic Sokoli n'dy tagana,
— Udha e marë, m'i ka thanë nana,
lufto bir, ti për Shqipni,
mos i le turqit pa i zhbi;*

1) «Këngë popullore historike», Tiranë 1962, f. 69.

*n'koftë nevoja vi me ty.
 Mis Sokoli ni fjalë po e flet,
 Po i thotë nanës: — Të mirë meç!
 pa u farua*) Malsia**) krejt,
 ktu nuk hi as krajl, as mret!!)*

Këtu poeti anonim, me një forcë të madhe përgjithësuese, përjetëson në vargjet e tij dy figura madhështore dhe të pavdekshme luftëtarësh të paepur: figurën e nënës shqiptare, që ditë të lindë, të rrisë dhe të edukojë trima, të cilët përlirinë e Shqipërisë shkrihen «*si me le*». Ajo jo vetëm i uron të birit që pushka t'i bëhet top dhe e porosit atë të luftojë «*për Shqipni*» derisa t'i «*zhibj*» pushtuesit osmanë nga vatani, por «*n'koftë nevoja*» është e gatshme të rrokkë armët dhe të shkojë në fushë të betejës, krah përkrah me burrat. Në përmasa të tillë sa madhështore aq realiste na ka dhënë edhe figurën e luftëtarit legjendar, Mic Sokolit, të armatosur «*n'dy tagin*» figurë kjo që simbolizon prijësin e luftëtarin popullor që kurrë nuk kthehet pas.

Në çastin e nisjes për në betejë, ai nënës, Shqipërisë, i jep fjalën e nderit, besën e shqiptarit, se «*pa u farue Malsita***) krejt, / ktu nuk hi as krajl, as mret!...»*

Ngjarjet e mëdha historike të Lidhjes Shqiptare vunë në lëvizje masat e gjera popullore dhe mendjet më të ndritura të kombit. Ato ushtruan një ndikim

*) shfarosë

**) Shqipëria

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 38.

***) Shqipëria

të madh në gjithë zhvillimin e ngjarjeve të pastajme historike.

Pas epokës së Skënderbeut Lidhja Shqiptare shënon ndeshjen e parë frontale të popullit shqiptar të organizuar në shkallë kombëtare me një koalicion armiqsh, ndeshje e cila u zhvillua shumë e ashpër si në fushën politike, ashtu dhe në atë ushtarake.

Gjatë kësaj periudhe historike populli shqiptar luftoi me armë në dorë dhe derdhi lumenj gjaku për të mbrojtur tërësinë tokësore, për bashkimin kombëtar dhe për krijimin e shtetit shqiptar.

Idealet, për të cliat luftoi Lidhja Shqiptare, mbetën në rend të ditës. Për realizimin e tyre populli shqiptar luftoi pareshtur gjatë tri dekadave të pastajme dhe, pasi derdhi të tjerë lumenj gjaku, duke çarë nëpërmes flakëve të luftës grabitqare ballkanike, më 1912 krijoi shtetin e tij të pavarur, «por tashmë në një territor të cunguar rëndë.»¹⁾

1) Alkes Buda, «Shqiptarët përballet kritikës lindore të viteve 1878-1881», revista «Ylli» nr. 2, Tiranë 1978.

IV

DY FJALË PËR VLERAT IDEORE E ARTISTIKE TË EPIKËS HISTORIKE TË KËSAJ PERIUDHE

Lidhja Shqiptare e themeluar në Prizren lindi, u rrit dhe u zhvillua në rrëthana shumë të ndërlikuara historike. Ajo lindi në një kohë kur Shqipërisë, veç pushtimit otoman, po i kërcenohej rreziku i copëtimit të tokave shqiptare, rreziku i shkombëtarizmit gradual dhe i zhdukjes si popull e si komb.

Për të përballuar këto rreziqe fatale, u formua Besëlidhja Shqiptare, e cila rrënjet e saj të thella i kishte te masat e gjera popullore. Ajo ishte vazhdimi dhe ngritja në një shkallë më të lartë e përpjekjeve dhe e luftërave të pareshtura të popullit tonë për liri e pavarsësi, për drejtësi shoqërore e përparim gjatë shekujve.

Lidhja Shqiptare, duke u mbështetur tëresisht në patriotizmin e flaktë, në shpirtin luftarak sulmues të masave popullore të vetarmatosura, në vendosmërinë e patundur të popullit tonë për të mbrojtur me gjak çdo pëllëmbë të trojeve të veta dhe për të lufthuar me ngulm për të shkëputur prangat e robërisë

osmane, duke dalë nga errësira në dritë, mori përsipër misionin e lartë historik: mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut, bashkimin kombëtar dhe realizimin e autonomisë, qoftë edhe me dhunë.

Besëlidhja Shqiptare, e mbrujtur me idetë e Rilindjes Kombëtare, i dha popullit shqiptar programin kombëtar politik e ushtarak dhe hapi një epokë të re e të vrullshme në historinë e përpjekjeve dhe të luftëtarëve të popullit tonë për liri e pavarësi.

Lidhja Shqiptare që në fillim u gjet përballë një koalicioni armiqsh lakmitarë. Populli shqiptar, ndonëse në kushte shumë të rënda të pushtimit dhe pa asnjë përkrahje nga jashtë, zhvilloi një luftë të pabarabartë, njëkohësisht në shumë fronte. Duke u mbështetur tërësisht në forcat e veta të pashtershme, me luftën e tij thellësisht popullore, ai përballoi sulme nga më të egrat si në fushën politike dhe në atë ushtarake dhe korri fitore të thella mbi koalicionin e armiqve. Kështu, ai shkroi një ndër faqet më të lavdishme të historisë së tij kombëtare dhe me grykë të pushkës e bëri çështjen shqiptare një nga problemet më të mprehta të politikës evropiane në Ballkan.

*
* *

Lidhja Shqiptare dhe ngjarjet e saj të stuhishme (qershor 1878 — prill 1881) shënuan një nga pikat kulminante dhe kthesë në historinë e popullit tonë. Të tillë janë edhe këngët popullore për këto ngjarje në kuadrin e epikës sonë historike. Ato shquhen

për gjerësinë e tyre tematike, për përbajtjen e shëndoshë ideore dhe për realizimin e tyre artistik.

Idealet e mëdha, ngjarjet jetike për kombin, virtytet e larta, besën shqiptare, largpamësinë, mbështetjen tërësisht në forcat e veta, dashurinë e pakufishme për vendin, urejtjen e thellë për pushtuesit e veglat e tyre, luftën konsekutive, gjenia krijuar e popullit tonë ka ditur t'i përjetësojë në epikën tonë historike:

Në këngët e këtij cikli kudo spikat koncepti i luftës për të gjithë Shqipërinë. Këngët theksojnë vitalitetin e Besëlidhjes Shqiptare, jehonën e saj të madhe kombëtare e ndërkombëtare, si dhe shqetësimet, panikun, hutimin e pasigurinë që u ka shkaktuar ajo armiqve: «*Me gazeta vesh e kam marrë / se krejt Shqipnija besë ka lidhë, / se ata e kanë besën pa prishë, / shtatë krajalat ndihmë me na dhanë, / na nuk mujmë më hi në Plavë*». Poeti anonim bën thirrje që Besëlidhja Shqiptare, bashkimi kombëtar, uniteti moralo-politik të forcohen dhe të ruhen si gjëja më e shtrenjtë.

Ngjarjet e Lidhjes Shqiptare shquhen për karakterin e tyre thellësisht popullor. Prandaj edhe këngët historike qenë kaq të shumta, kaq të ndjera e kaq të frymëzuara. Ato lanë një vragë të thellë e të pashlyeshme dhe sollën një pasurim të rëndësi-shëm në epikën tonë historike.

Në këngët popullore që flasin për këto ngjarjet del në relief dhe me ngjyra të forta realiste karakteri masiv popullor i këtyre luftërave, gjerësia dhe ashpërsia e tyre.

Këngët popullore të këtij cikli nxjerrin në pah

aftësitë luftarake të popullit tonë. Aty spikat etja e pashuar për liri e pavarësi kombëtare; vendosmëria e masave popullore për t'u fliuar për çdo pëllëmbë të trojeve shqiptare; egërsia e armiqve dhe urrejtja e pakufishme ndaj këtij koalicioni agresorësh, që sulen me aq egërsi e barbarizëm kundër Atdheut tonë. Aty spikat qëndrimi i prerë ndaj çdo kompromisi, intrige, diversioni dhe tradhtie të pashallarëve, bejlerëve e klerikëve antikombëtarë. Në këto këngë ndihet besimi i patundur i popullit kryengritës në armët e veta të bashkuara, optimizmi i thellë, qartësia dhe mprehtësia politike, burrëria, guximi, heroizmi masiv, gatishmëria luftarake për t'u matur përsëri në fushë të betejës me të gjithë koalicionin e fuqishëm të armiqve, duke mbrojtur me gjak interesat e larta të Atdheut.

Këto motive të larta i shtyjnë forcat popullore të Lidhjes, bijtë e thjeshtë të popullit, «fukaranë», që «pa opanga në kamë», e «pa bukë në bark» të rrokin armët «n'shat' e n'shtatëdhetë», vjeç dhe nga «pesë për shpi» të shkojnë në vijë të parë të frontit në ngjarjet e Gjakovës, në mbrojtjen e viseve shqiptare të kërcënua dhe në betejat e tjera kundër hordhive të shumta osmane. Këto i shtyjnë masat popullore të hidhen «rrema-rrema» në flakët e verdha të pushkëve, në llogoret e pushtuesit, në majat e thi-kave dhe në grykat e topave.

Poëtët popullorë anonimë, në vargjet e tyre plot ndjenja, pa asnjë notë idealizimi, na kanë dhënë një galeri të tërë monumentesh të pavdekshme të heroizmit popullor, të udhëheqësve politikë e ushtarakë, të komandantëve të shquar popullorë dhe të luftë-

tarëve të thjeshtë. Të tillë na jepen në epikën historike udhëheqësit e shquar politikë e ushtarakë, që qëndruan në ballë të përleshjeve: Abdyl Frashëri e Sulejman Vokshi; komandanët e talentuar të formacioneve ushtarake të Lidhjes: Mic Sokoli, Ali Ibra, Haxhi Zeka, Jakup Feri, Islam Aga, Mulla Jaha, Kadri Bajri, Sali Jaha, Sef Kosharja, Isuf Sokoli, Mehmet Beci, Mehmet Gjylli, Hajdar Feka, Haxhi Brahimë, Idriz Alidhima, Jusuf Dibra, Nurçe Pustina, Hasan Haxhia, Man Avdia, Mal Dula, Ramadan Zaskoci, etj. Në vargjet e këtij cikli vend të veçantë zënë luf-tëtarët e thjeshtë që derdhën gjak në fushë të betejës: Col Delia, Sokol Çela, Sadik Hamza, Çel Shabani, Zhuj Kasemi, Dem Isufi, Rexhë Avdia, Zhuj Selmani, Zmajl Hyseni, Bajram Rama, Zmajl Mehmeti, Ali Neza, Met Rustemi, Niman Sula e qindra e qindra të tjera, të cilët mbetën si shembuj të lartë të guximit, trimërisë e heroizmit masiv për brezat pasardhës.

Këngët popullore evokojnë traditat patriotike-luftarake të popullit tonë. Në vargje të frymëzuara të derdhura si në bronz: «*Kshtu Kosova e ka pasë adet, /ka ni pashë me e mytë për vjet!*»/ është përgjithësuar një e vërtetë e madhe historike: luftërat e pareshtura të popullit tonë për liri e pavarësi, vazhdimësia e tyre dhe mbarimi i turpshëm ku kanë përfunduar pushtuesit. Në mënyrë të vendosur e krenare paralajmërohet Porta e Lartë dhe të gjithë ata agresorë që do të guxonin të zgjatnin kthetrat e tyre grabit-qare në tokën shqiptare se do të linin kokën ashtu siç e la Mehmet Ali Pasha e shumë pashallarë të tjerë.

Në gjirin e këtyre përpjekjeve dhe luftërave vigate të popullit tonë u bë edhe diferencimi politik klasor. Ky diferencim që shkoi gjithnjë duke u thelluar, pasqyrohet gjerësisht në këngët popullore që u kushtohen ngjarjeve të stuhishme të Lidhjes Shqiptare. Në këngët që flasin për ngjarjet e Gjakovës, përmbrojtjen e tërësisë tokësore, si edhe në ato që flasin përmbrojtjen e Lidhjes Shqiptare nga hordhitë osmane, me një forcë të veçantë spikat qëndrimi i prerë antiosman, antiimperialist dhe antishovinist.

Këngët popullore demaskojnë pa mëshirë qëndrimin reaksionar: komplotet, intrigat, diversionin e tradhtinë e atyre pashallarëve, bejlerëve e klerikëve reaksionarë shqiptarë, të cilët, të trembur përvdekje nga vrulli i pandalshëm patriotik-revolucionar i masave të gjera popullore, përtë ruajtur e forcuar privilegjet e tyre feudale, shkelën Besëlidhjen Shqiptare, tradhtuan interesat e larta kombëtare dhe u bënnë mbështetje kryesore politiko-shoqërore e regjimit të pushtimit osman.

Gjenia krijuese e popullit tonë, duke u mbështetur në përvojën shekullore të të parëve tamë, nga pozita thellësisht materialiste, me pjekuri të thellë politike, forcën kryesore lëvizëse të shoqërisë shqiptare përliri e pavarësi kombëtare, përdrejtësi e përparrim shoqëror, përmbrojtjen e tërësisë tokësore dhe përbashkimin kombëtar e krijimin e shtetit shqiptar e sheh në gjirin e vet masave të gjëra popullore, kurse te bashkëpunimi, ortakllëku i kryengritjes me pashallarët, bejlerët e klerikët turkomanë sheh kan-grenën vdekjeprurëse në trupin e kombit shqiptar. Prandaj qëndrimin e prerë klasor që duhej mbajtur

ndaj feudalëve e bezlerëve reaksionarë e ka tipizuar me një forcë të madhe përgjithësuese në vargjet e vëna në gojën e një luftëtarë popullor me përvojë: «*more mixhë, ty t'kam kallxue, / beglert' miç*) t'kam thanë s'i due»¹⁾*

Këngët popullore të kësaj periudhe e pasuruan epikën tonë historike me temën e mbrojtjes së tërësisë tokësore të Atdheut si në fushën politike edhe në atë ushtarake nga synimet imperialiste e lakmitë shoviniste. Me një forcë të veçantë demaskohen qëllimet grabitqare të shovinistëve fqinjë për pushtimin e tokave shqiptare, si dhe bashkëpunimin e «*shtatë krajlate*» dhe të «*dovletit*» me shovinistët e panginjur në kurri të popullit shqiptar. Këngët historike nxjerrin në relief vendosmërinë dhe gatishmërinë luftarake të popullit shqiptar për të mbrojtur me gjak trojet e të parëve, e «*rob askujt mos me ju ba*». Ato na tregojnë se për mbrojtjen e tokave shqiptare është ngritur në këmbë e tërë Shqipëria.

Mbrojtja e tokave shqiptare nuk është më vetëm detyrë e krahinave të kërcënuara, por e tërë popullit shqiptar, prandaj këngët nënvisojojnë se «*n'ka-tër anët potera ka krisë*», e «*krejt Shqipnija n'kufi a dal*».

Gjithashtu, këngët tregojnë egërsinë e brutalitetin e qarqeve shoviniste ballkanike, të Fuqive të Mëdha imperialiste dhe të Portës së Lartë, që me veprime të bashkërenduara vërsulen si kope ujqish të tërbuar për të mposhtur qëndresën e popullit

*) miç

1) «Për vend tonë jem tuj luftue», Tiranë 1968, f. 46.

shqiptar, i cili guxon të barabitet dhe të korrë fitore politike e ushtarake mbi ta.

Tema tradicionale e luftës kundër pushtuesve shekullorë osmanë tani merr një gjerësi e një thellim të mëtejshëm.

Masat e gjera populllore, të gjendura ballë për ballë me pushtuesit osmanë, njohën edhe një herë politikën mashtruese e prapaskenat e Portës së Lartë në kurriz të interesave jetësore të tyre. Ato provuan drejtpërdrejt kërcënimet politike e ushtarake dhe goditjet pas shpine. U bindën se zgjedhën osmane mund ta thyenin vetëm duke u mbështetur tërësisht në forcën e armëve të veta të bashkuara.

Kjo duket në mënyrë të veçantë në përgjigjen krenare dhe kërcënuese që i japin luftëtarët e Lidhjes Ahmet Myftar pashës dhe vetë sultani Hamidit: «*Me tokë teme mreti ç'ka ka?*»; «*ti shëndosh për Pejë e Gjakovë*» se «*pa to je metë*», «*në kambë u çua shqiptaria*», për «*me i dalë zot vatanit*» etj.

Lëvizja e armatosur për vetëmbrojtjen e tokave shqiptare nga synimet imperialiste e lakmitë e shovinistëve fqinjë dhe lëvizja për bashkimin kombëtar në një *shtet* të vetëm, *ishin shkrirë* në një të *vetme*, sepse në forcat populllore të Lidhjes tani nuk kishte më iluzione për sa i përket politikës antishqiptare që po ndiqte Stambolli ndaj interesave më të larta të Atdheut: «*na s'e lëshojmë Shqipërinë, /na domë autonominë!*»

Lëvizja e fuqishme për autonomi ngriti peshë masat e gjera populllore dhe thelloi diferencimin politik klasor në gjirin e kësaj lëvizjeje.

Në këngët popullore që u kushtohen këtyre ngjarjeve tingëllojnë thekshëm terma e fjalë që shprehin koncepte shumë të qarta politike: «*jemi vetëm shqiptar*», «*krejt Shqipnija...*», «*për vend tonë jem' tuj luftue*», «*jemi nisë me u ba milet*», «*shah n'veti don me kanë, /kurrgja mretit mos me i dhanë...*» etj. etj.

Me këto pikësynime të qarta zhvillohen edhe luftimet e përpjekjet e ashpra antishoviniste, anti-imperialiste e antiosmane. Kështu, në këngët e këtij cikli kudo spikat kalimi nga luftërat lokale e krahi-nore në luftërat me karakter kombëtar për një ideal të madh të përbashkët, për Shqipërinë, gjë që shënon një hop cilësor në forcimin dhe zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit tonë.

Këngët popullore të kësaj periudhe shquhen për përbajtjen e shëndoshë ideore, për qartësinë e tyre politike. Gjendja e forcave ndërluftuese na jepet me objektivitet pa nënvylerësuar ose mbivlerësuar as forcat e veta, apo ato të kundërshtarit. Kudo spikat besimi i patundur se populli shqiptar do të triumfojë mbi armiqëtë e shumtë, sepse ai bënte një luftë të drejtë, luftonte për vendin e vet, për të drejtat e tij kombëtare, për trojet e veta. Në asnjë variant, në radhët e luftëtarëve apo të udhëheqësve të Lidhjes nuk ndeshet asnjë nuancë frike, paniku e hutimi. Kudo spikat optimizmi, besimi në fitore.

Edhe vlerat artistike të këtij cikli janë të mëdha. Ato shquhen për përdorimin e mjeteve të larmishme e të fuqishme artistike, si edhe për gjuhën e pasur, të thjeshtë e të gjallë popullore.

Me një mjeshtëri të rrallë janë përdorur epitetë

të shumta pér tipizimin dhe individualizimin e heronjve të betejave të mëdha të forcave të Lidhjes: «*djelt e Markit po bajnë be: — Me ksi trimash kurr s'jem pre!*»; epitete të shumtë e të goditura ka-dhe pér tipizimin e pushtuesve e të tradhtarëve; krahasime të fuqishme «*qet dervisha ma zi se korbi!*»; mjetë groteske pér demaskimin e armikut, siç janë ironia e hollë, sarkazma therëse e dërrmuese «*me i pasë kraht me fluturue, / gjallë prej kullës s'të lamë me shkue*» etj.

Këngët e këtij cikli, me një aftesi të rrallë poetike, na i paraqesin këto ngjarje të stuhishme në tërë gjerësinë, madhështinë e heroikën e tyre.

Të gjitha këto situata poeti popullor na i jep duke kombinuar me mjeshtëri të rrallë artistike rastet e veçanta me situatat e përgjithshme tipike, duke krijuar kështu figura pozitive e negative me veti e tipare përgjithësuese. Të tilla janë figurat e udhëheqësve popullorë të lartpërmendur, që prijnë vazhdimisht në ballë të sulmit dhe të luftëtarëve të thjeshtë, që pér mbrojtjen e idealeve të mëdha të Atdheut kanë nga «*shtatë zemra*» dhe «*bajnë deken si me le*».

Këto figurat mishërojnë vitalitetin e një populli luftëtar sypatrembur.

«*Të shtatë krajlat e mretit*», që bëjnë tregti me trojet tonë, pashallarët më gjakatarë, si Mehmet Ali pasha, Ahmet Myftar pasha, Dervish pasha, etj., që i ka dërguar sultani; apo kryeshovinistët e tërbuar, knjaz Petroviçit, Mark Milani etj., janë komandanët e hordhive të shumta që vijnë pér të gjunjëzuar e shtypur, grabitur e shkombëtarizuar popullin

shqiptar me forcën e armëve të tyre gjakatare. Ata janë personifikimi i forcave më të errëta, i shtypjes nationale, i grabitjes, terrorist e masakrave në masë, i shkombëtarizimit të popujve, i errësirës mesjetare dhe i thundrës së rëndë të pushtuesit gjakatarë. Kurse Abdulla Pashë Dreni etj. janë shkelësit e Besëlidhjes Shqiptare, që «*kanë shitur fukaranë*», që bëhen vegël dhe mbështetje e pushtuesit, për t'i vënë zjarrin popullit e vendit, janë njerëzit që në çdo kohë «*shesin fukaranë*» dhe i ngulin thikën pas shpine Atdheut.

Kudo në vargjet e këtyre këngëve ndihet e gjallë, e freskët, ushtima e betejave, atmosfera epike e luftërave të pabarabarta, heroizmi populor, që buron nga dashuria e madhe për atdheun, nga urrejtja e thellë kundër çdo lloj shtypjeje e tiranie. Nga kauza e drejtë e luftës për ideale të mëdha, ndihet optimizmi i thellë tradicional i masave të gjera popullore, të cilat, duke mos iu nënshtruar vuajtjeve, mjerimeve të luftës, terrorist të egër mesjetar, kercënimit e shantazhit të fuqive imperialiste, vringëllimit të armëve të shovinistëve fqinjë, prapëseprapë mendojnë: «*qysh ta bajmë edhe 'i luftë tjetër opet*» për të realizuar aspiratat e veta, programin kombëtar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Djepi kryesor i këngëve popullore historike të kësaj periudhe janë krahinat ku u përqëndrua më gjerë zhvillimi i ngjarjeve politike e luftarake, si Kosova, Shkodra, Dibra, Gjirokastra etj. Ato shtrihen që nga Plava e Gucia, Hoti, Gruda, Kelmendi, Ulqini,

Tivari, Tetova, Gostivari e gjer në Labëri, Sarandë e Çamëri. Ato në viset e Shqipërisë Veriore e Verilindore këndohen nga një ose dy këngëtarë si këngë «*maje krahu*», ose nëpër oda e kuvene dhe shoqërohen me çifteli, apo lahitë, kurse në viset e Shqipërisë së Jugut këndohen me kor.

Këto këngë, që këndohen me të madhe sot e kësaj dite, përbëjnë një thesar të madh jo vetëm pér përbajtjen e shëndoshë patriotike-luftarake, po edhe pér nivelin e tyre të lartë artistik. Ato kanë vlera të mëdha dokumentare, sepse na zgjerojnë shumë formacionin historik pér zhvillimin e këtyre ngjarjeve të stuhishme. Madje në disa drejtime ia kalojnë dokumentacionit historik, i cili asqë i zë fare në gojë bëmat e heroizmin e luftëtarëve të thjeshtë, kurse epika historike vlerëson lart, jo vetëm udhëheqësít, por edhe veprën e luftëtarëve populorë. Epika historike është një reflektim i drejtëpërdrejtë i përpjekjeve dhe i luftërave vigane që bëri populli ynë gjatë gjithë periudhës së Lidhjes Shqiptare dhe dekadeve që e pasuan kundër pushtuesve otomanë dhe lakmive të shteteve shoviniste e synimeve imperiale.

Këngët historike kanë lindur në betejat e luftës popullore kundër të gjithë koalicionit të armiqve. Ushtima e menjëherershme e këtyre betejave të përgjakshme, plot situata epike, ka ndezur fantazinë e poetëve anonimë.

Në këngët popullore është fiksuar atmosfera e betejave të përgjakshme: rrjedhimet e ngjarjeve, gjëzimet e fitoreve, hidhërimet, rënia në fushën e ndërit e bijve më të mirë; optimizmi i thellë, vendos-

mëria e patundur, besimi në forcën e armëve të veta dhe gatishmëria luftarake e masave të gjera popullore për t'u hedhur prapë e prapë në beteja të reja vendimtare.

Këngët popullore sjellin shumë episode të hollësishme, të dhëna të sakta për rrethanat e zhvillimit të ngjarjeve luftarake, për ndjenjat që jetojnë masat popullore në periudha e ngjarje të caktuara, për qëndrimin kritik që mbajnë masat e giera popullore ndaj tyre si edhe për përpjekjet e ethshme të të gjithë armiqve të jashtëm e të brendshëm, për egërsinë e tyre me të cilën vërsulen mbi popullin tonë përtatë gjunjëzuar, copëtuar, skllavëruar, shkombëtarizuar dhe përtatë si popull e si komb.

Epika historike, duke ngritur lart gjestet heroike të luftëtarëve të Lidhjes, të cilët u hodhën në aq e aq beteja të përgjakshme dhe duke i paraqitur këto me një perspektivë optimiste të thellë dhe besim të patundur në fitore, i dha kulturës kombëtare një veç për monumentale që ruan gjithnjë aktualitetin e saj dhe shërben si burim i madh fryshtëzimi për edukimin patriotik luftarak dhe estetik të popullit tonë. Këto këngë edukuan breza të tërë luftëtarësh popullorë me dashurinë e pakufishme për Atdheun, me urrejtjen e thellë kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm e veglat e tyre si edhe besimin e patundur në forcat e veta dhe në fitoren mbi armiqtë e shumtë.

Për këtë arsy, Partia jonë heroike, trashëgimtarja më e denjë e traditave më të mira të popullit tonë, ka ngritur shumë lart të gjithë trashëgiminë patriotike luftarake të të parëve tanë. Ajo, duke embruajtur me ideologjinë e pavdekshme marksiste-

-leniniste, e bëri atë armë të saj në betejat fitimtare të popullit tonë mbi pushtuesit fashistë italo-gjermanë e veglat e tyre, si edhe për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit popullor dhe të socializmit nga armiqtë e shumtë imperialisto-revizonistë e tradhatarët.

Këngët popullore që lindën në zjarrin e betejave **heroike** të periudhës së Lidhjes Shqiptare ruajnë gjallërinë dhe freskinë e tyre, përbajtjen e thellë patriotike e luftarake. Ato fund e krye përshkohen nga **fryma** e qëndresës dhe e mosnënshtimit ndaj asnje fuqie në botë.

Epika historike e këtyre ngjarjeve ashtu si i gjithë folklori historik në përgjithësi është historia e gjallë e popullit tonë, të cilën e ka shkruar me gjakun e tij dhe e ka pérjetësuar në këngën e vet.

F u n d

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Hyrje	5
«Pa u shkri n'shtatë e n'shtatëdhetë, rob askuj nuk mujmë me u ba!»	11
«Me gazeta vesh e kam marrë, se tanë Shqipnia besë ka lidhë...»	39
«Na s'e lëshojmë Shqipërinë, na duam autonominë!»	77
Dy fjalë për vlerat ideore e artistike të epikës historike të kësaj periudhe	113